



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.141/21 prot.

Datë 10.05.2024

V E N D I M
Nr.500/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.05.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë*”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Inpress*” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërme

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel CO” SHPK me NIPT L22117021M dhe adresë Rruga “Myslym Keta”, Ish Rezevat e Shtetit, Tiranë

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me Nipt L52122014L dhe adresë Adres Adresa: Rruga “Siri Kodra”, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Tiranë

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.8, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare SH.A me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” me NIPT J72124001N dhe adresë Autostrada Tirane – Durres, Km.10, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19-10-2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.

II.2. Në datën 20.11.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “Infosoft Office” sh.p.k	36,750,200.00 lekë pa tvsh	kualifikuar
2-OE “Dynamic Group” sh.p.k	39,500,000.00 lekë pa tvsh	skualifikuar
3-OE “Marketing&Distribution” sh.p.k	44,800,000.00 lekë pa tvsh	kualifikuar
4-OE “Inpress” sh.p.k	47,040,000.00 lekë pa tvsh	kualifikuar

5-OE “Adel Co” sh.p.k	63,192,000.00 lekë pa tvsh	kualifikuar
6- OE “Kristalina.KH”	64,700,000.00 lekë pa tvsh	kualifikuar

II.4. Në datën 16.01.2024, është publikuar Njoftimi i Fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 22.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 141/2024 prot, datë 22.01.2024 e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, “Infosoft Office” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 141/2 prot., datë 23.01.2024 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomik “Inpress” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.6. Në datën 24.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3768, protokolluar me nr. 169/2024 protokollin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, si dhe operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.169/2 prot., datë 25.01.2024 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “ Inpress” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomik “Infosoft Office” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, “Adel CO” SHPK, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Në datën 25.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3772, protokolluar

me nr. 179/2024 protokollit e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “Inpress” SHPK.

II.7.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.179/2 prot., datë 26.01.2024 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “ Infosoft Office” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomik “Adel CO” SHPK dhe “Inpress” SHPK.

II.8 Me anë të shkresës nr. 2080/26 prot., datë 02.02.2024, me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: Loti i II -të: “Blerje letër A5 “Traktor” 3 kopje, letër A4, Traktor (3 kopje), autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, “Infosoft Office” SHPK dhe “Marketing & Distribution” SHPK referuar shkresës, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin si më poshtë vijon:

Me shkresën nr. 2080/21 prot., datë 01.02.2024 (një kopje i është dërguar për dijeni edhe KPP-së), I është kthyer përgjigjë operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk NUIS L22117021M me përmbajtje si vijon:

Në përgjigje të ankesës tuaj ardhur në “Posta Shqiptare” SH.A me nr. 2080/10 prot., datë 22.01.2024 lidhur me vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit REF-84246-10-18-2023, Loti i II-të: “Blerje letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor (3 kopje), me fond limit me vlerë 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A me procedurë prokurimi “procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” në formë elektronike, zhvilluar në datë 20.11.2023 ora 10:00 ku pretendohet se, AK-ja ka kryer vlerësim të karakterit sipërfaqësor, duke kualifikuar oferta të pavlefshme që nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim sipas përcaktimeve të DST-së, ju informojmë si më poshtë:

- 1. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku mendoni se skeda teknike e dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk me NUIS J62426002Q në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-së nuk përmbush parametrat teknike të kërkuar ju informojmë se:*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga operatori “Infosoft Office” SHPK NUIS J62426002Q, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-së rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

-Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Algrafika" Tiranë, i cili garanton suport për furnizim e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedurë, e cila mbanë datën 15.11.2023

- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" ku deklaron si Distributor të autorizuar "Algrafika" Tiranë si dhe deklaron furnizimin e këtij distributori me këto produkte (leter pa karbon).

- Skedën teknike (specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi letër A5 "traktor" (3 - kopje), letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave teknike të parashikuara në shtojcën 5, të DST-së me skedën teknike të paraqitur nga operatori "Infosoft Office" SHPK e lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" të dhënat teknike të ofertuar në tender rezultojnë të njëjta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknike të kërkuara në dokumentet standarte të tenderit.

Përsa më sipër autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

2. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se "operatori ekonomik **"Marketing & Distribution"** SHPK NUIS J72124001N nuk përmbush plotësisht kriteret tekniko ligjore për kualifikim pas mungojnë kontrata të ngjashme me letër kimike të realizuara si dhe skeda teknike e dorëzuar nuk përmbush parametrat teknike të kërkuar ju informojmë se:

- Lidhur me përmbushjen e kontratave të ngjashme sqarojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertes nga Operatori "**Marketing & Distribution**" SH.P.K., rezulton se në përmbushje të kapaciteteve teknike pika 2.3.1, ku kërkohet që: operatori Ekonomik duhet të paragesë **furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit**, me vlerë jo më pak se 38 % e vleres së fondit limit, rezulton se janë dorëzuar kontrata dhe fatura të realizuara ku në përmbajtje të tyre rezulton se janë kryer furnizime me përmbajtje **leter fotokopje** si dhe me furnizime **leter traktor**.

Perderisa në DST si dhe në pikën 4. të nenit 40, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar, kërkohen kontrata me natyrë të ngjashme (jo të njëjta), paraqitja e kontratave dhe faturave të realizuara me furnizime leter fotokopje dhe leter traktor ku si bazë kanë furnizimin me produkte "Leter", për autoritetin kontraktor është vlerësuar si kriter i përmbushur.

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.5 të DST-së, sqarojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertes nga Operatori "**Marketing & Distribution**" SH.P.K., në përmbushje të pikës 2.3.5 te DST rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Grafotisak" Grude, Bosnjë Hercegovinë, i cili garanton suport për furnizimin e nevojshem të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe Gmbh" sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedurë. e cila mbanë datën 24.08.2022.
- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe Gmbh" ku deklaroi si Distributor të Autorizuar "Algrafika" Tiranë si dhe deklaroi furnizimin e këtij distributori me këto produkte (leter pa karbon).
- Skeden teknike (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi **Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.**

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhenave teknike të parashikuara në Shtojca 5, të DST-së me skeden teknike të paraqitur nga operatori "Marketing & Distribution" SH.P.K., e lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe Gmbh" të dhenat teknike të ofertuara në tender rezultojnë të njëjta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknike të kërkuara në dokumentet standarte të tenderit.

Për sa me sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson te përmbushura keto kriter dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejte.

3. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se Operatori "**Inpress**" SH.P.K. NUIS L52122014L nuk përmbush plotësisht kriteret tekniko ligjore për kualifikim pasi mungojnë kontrata të gjashme me leter kimike të realizuara si dhe Skeda teknike e dorëzuar, nuk përmbush parametrat teknik të kërkuar si dhe nuk ka përkthyer dhe noterizuar dokumentat të cilat janë në gjuhë te huaj. ju informojmë se:
 - Lidhur me përmbushjen e kontratave të ngjashme sqarojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje te ofertes nga Operatori "**Inpress**" SH.P.K., rezulton se në përmbushje të kapaciteteve teknike pika 2.3.1. ku kërkohet që: operatori Ekonomik duhet të paragesë **furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit**, rezulton se janë dorëzuar kontrata dhe fatura të realizuara ku në përmbajtje të tyre rezulton se janë furnizime me **leter të përpunuar (Shirita printimi, Rulona përmbledhës për pulla, Pulla kontrolli me elemente sigurie, Shtyshkrime)**. Perderisa në DST si dhe në pikën 4, të nenit 40. të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "**Per Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike**" i ndryshuar, kërkohen kontrata me natyrë të ngjashme (jo të njëjta), paraqitja e kontratave dhe faturave të realizuara me furnizime **leter të përpunuar** ku si bazë kanë furnizimin me produkte "Leter", për autoritetin kontraktor është vlerësuar si kriter i përmbushur.

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.5 të DST-së, sqarojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga **Operatori "Inpress" SH.P.K.**, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST- rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

-Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Office Paper" Tirane, i cili garanton suport për furnizimin e nevojshem të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Goodëill Group Limited" L.T.D., Kinë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedure, e cila mbanë datën 24.08.2022.

- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Goodëill Group Limited" L.T.D., Kinë, ku deklaron si Distributor të Autorizuar "Office Paper" Tiranë si dhe deklaron furnizimin e këtij distributori me këto produkte (leter vetkopjues).

- Skeden teknike (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi Letër A5 "Traktor" (3 kopje), **Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.**

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i te dhenave teknike te parashikuara ne Shtojca 5, te DST-se me skeden teknike të paraqitur nga operatori "**Inpress**" SH.P.K. e lëshuar nga prodhuesi "Goodeill Group Limited" L.T.D., Kinë, të dhenat teknike te ofertuara në tender rezultojne te njejta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknik të kërkuara në dokumentat standarte te tenderit.

- Lidhur me pretendimin se në ofertë janë dorëzuar dokumenta që nuk ka përkthyer dhe noterizuar dokumentat të cilat janë në gjuhë të huaj, sqarojmë se:

Nga verifikimi i dokumentacionit te ofertës rezulton se Autorizimi i Prodhuesit për distributorin dhe specifikimet teknike të cilat janë në gjuhë angleze, megjithse procedura "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar" dhe oferta mund të dorëzohet si në gjuhën shqip ose anglisht (përcaktuar edhe në DST), përsëri sqarojmë se këto dokumenta janë edhe të përkthyer në gjuhën shqipe si dhe të noterizuara dhe mbajnë datën 14.11.2023.

Per sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushura këto kriter dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejtë.

4. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se kampionet e dorëzuar nga operoret "**InfoSoft Office**" SH.P.K. NUIS J624260020: "**Marketing & Distribution**" SH.P.K. NUIS J7212400IN; "**Inpress**" SH.P.K. NUIS L52122014L nuk përmbushin plotësisht parametrat teknik të parashikuar në DST, ju informojmë se:

Autoriteti ynë kontraktor bazuar në pikën 6/a, të nenit 40, të VKM-së nr. 285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar, ka kërkuar si dhe ka trajtuar mostrat e mallit (modelet), si informacion konfidencial tregtar dhe janë në

kontroll të autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i mostrave të mallit (modelet), të dorëzuara nga operatorët "InfoSoft Office" SH.P.K. NUIS J62426002Q; "Marketing & Distribution" SH.P.K. NUIS J72124001N; "Inpress" SH.P.K. NUIS L52122014L vlerësohen se i përmbushin parametrat teknik të parashikuar në DST dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejtë.

Për sa më sipër, ankesa e paragitur nga ana Juaj, është shqyrtuar me shumë vëmendje nga Autoriteti ynë Kontraktor por pretendime e ngritura në ankesë nuk vlerësohen të drejta.

- **Me shkresën nr. 2080/22 prot. Datë 01.02.2024 (një kopje i është dërguar për dijeni edhe KPP-së), i është kthyer përgjigje operatorit ankimues "Infosoft Office" SHPK NUIS J62426002Q, me përmbajtjen si vijon:**

Ne përgjigje te ankeses tuaj, paraqitur ne KPP ardhur ne "Posta Shqiptare" Sh.A.. me Nr. 2080/10 prot. date 22.01.2024, lidhur me vlerësimin e ofertave te procedures se prokurimit REF-84246-10-18-2023, Loti i II-të: "Blerje Letër AS "Traktor" (3 kopje), Leter A4 "Traktor" (3 kopje)", me fond limit: Loti i II-të: "Blerje Leter A5 "Traktor" (3 kopje), Leter A4 "Traktor" (3 kopje)", me vlerë 65,464,000 (gjashtedhjetë e pese milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë, pa TVSH., vënë ne dispozicion nga te ardhurat e vete Shogërisë "Posta Shqiptare" sh.a., me procedure prokurimi "Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar", ne formë elektronike, zhvilluar me date 20/11/2023, ora 10.00. ku pretendohet se, ofertat e ofertuara nga operatorët e kualifikuara "Adel CO" SHPK dhe "Inpress" SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim sipas përcaktimeve të DST-së dhe duhen skualifikuaj, ju informojme si me poshte:

1. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku **pretendoni** se operatori "Adel CO" SHPK nuk përmbush pikat 2.2.1: 2.3.5 dhe 2.3.6 ën e DST-së: ju informojme se:
 - Lidhur me përmbushjen e pikës 2.2.1 të DST-së, **ku parashikohet se:** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 199% të vlerës limit të kontratës që prokurohet, ju informojme se:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertes nga Operatori "Adel CO" SHPK, në përmbushje të pikës 2.2.1 të DST- rezulton se përveç dokumentacionit që ka paragitur për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga ky operator, në mbështetje të pikës 4, të nenit 90 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit shogëruar edhe me dokumentacion për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga operatori "NDERTIMI" shpk NIPT-i: K11325002C.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga sa theksuar më sipër rezulton se ky kriter përmbushet plotësisht nga ky operator.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me përmbushjen e pikave 2.3.5 dhe 2.3.6 të DST-së ku kërkohet **që mostrat e dorëzuara nga ofertuesi “Adel CO” SHPK të dërgohen për tu analizuar në një laborator të akredituar për produktet e letrës**, ju informojme se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga operatori **“Adel Co” SHPK**, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-së, rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Algrafika" Tirane, i cili garanton suport për furnizimin e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedurë
- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" ku deklaron si Distributor të Autorizuar "Algrafika" Tiranë si dhe deklaron furnizimin e këtij distributori me këto produkte (leter pa karbon).
- Skeden teknike (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi **Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.**

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave teknike të parashikuara në Shtojca 5, të DST-së me skeden teknike të paraqitur nga Operatori "Adel CO" SHPK e lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" të dhënat teknike të ofertuara në tender rezultojnë të njëjta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknik të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Referuar autorizimit të distributorit të autorizuar, autorizimit të prodhuesit për distributorin e autorizuar, Skedës teknike të prodhuesit të paraqitur në tender (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi **Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**, në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe si dhe verifikimit fizik të mostrave (kampionit) të mallit krijohet bindja se ky operator i përmbush plotësisht kriteret tekniko ligjore për kualifikim.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

2. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se Operatori **"Inpress" SH.P.K. NUIS L52122014L** nuk përmbush plotësisht kriteret tekniko ligjore për kualifikim pasi mungojnë kontrata të gjashme, ju informojmë se:

- Lidhur me përmbushjen e kontratave të ngjashme sqarojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori **"Inpress" SH.P.K.**, rezulton se në përmbushje të kapaciteteve teknike pika 2.3.1, ku kërkohet që: operatori Ekonomik duhet të paraqesë **furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit**, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit, rezulton se janë dorëzuar kontrata dhe fatura të realizuara ku në përmbajtje të tyre rezulton se janë furnizime me **leter të përpunuar (Shirita printimi, Rulona përmbledhës për pulla, Pulla kontrolli me elemente sigurie, Shtyshkrime)**.

Përderisa në DST si dhe në pikën 4 të nenit 40, të VKm-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, kërkohen kontrata me natyrë të ngjashme (jo të njëjta), paraqitja e kontratave dhe faturave të realizuara me furnizime **letër të përpunuar** ku si bazë kanë furnizimin me produkte "letër" për autoritetin kontraktor është vlerësuar si kriter i përmbushur.

- Lidhur me përmbushjen e pikave 2.3.5 dhe 2.3.6 të DST-së ku kërkohet që **mostrat e dorëzuara nga ofertuesi "Inpress" shpk të dërgohen për tu analizuar në një laborator të akredituar për produktet e letërs** ju informojmë se:

Nga shqyrtimi I dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga operatori **"Inpress" shpk** në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Autorizim nga distributori I autorizuar "Office paper" Tiranë, I cili garanton suport për furnizimin e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Goodëill Group Limited" L.T.D Kinë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedurë, e cila mban datën 24.08.2022.
- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Goodëill Group Limited" LTD Kinë, ku deklaroi si Distributor të autorizuar "Office Paper" Tiranë si dhe deklaroi furnizimin e këtij distributori me këto produkte (letër vetëkopjuese)
- Skedën teknike (specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi letër A5 "Traktor" (3 kopje), letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave teknike të parashikuara ë shtojcën 5, të DST-së me skedën teknike të paraqitur nga operatori **"Inpress" SHPK** e lëshuar nga prodhuesi "Gooduill Group Limited" LTD Kinë, të dhënat teknike të ofertuara në tender rezultojnë të njëjta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknikë të kërkuara në dokumentet stabdarte të tenderit.

Referuar autorizimit të distributorit të autorizuar, autorizimit të prodhuesit, skedës teknike të prodhuesit të paraqitur në tender (specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi **letër A5 "traktor" (3 kopje), letër A4 "Traktor" (3 kopje)**, në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe të noterizuar edhe në gjuhën shqipe si dhe verifikimit fizik të mostrave (kampion) të mallit krijohet bindja se ky operator I përmbush plotësisht kriteret tekniko ligjore për kualifikim.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim I ngritur në ankesë vlerësohet jo I drejtë.

Për sa më sipër, ankesa e paraqitur nga ana juaj prënë KPP-së është shqyrtuar me shumë vëmendje nga autoriteti ynë kontraktor por pretendimet e ngritura në ankesë nuk vlerësohen të drejta.

- **Me shkresën nr. 2080/22 prot., datë 01.02.2024 (një kopje I është dërguar për dijeni edhe KPP-së), I është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Marketing & Distribution" SHPK me përmbajtje si vijon:**

Në përgjigje të ankesës tuaj ardhur ne "Posta Shqiptare" Sh A., me Nr. 2080 13 prot date 25.01.2024, lidhur me vleresimin e ofertave te procedures se prokurimit REF-84246-10-18 2023, Loti i 11-t8: "Blerje Leter AS "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)" me fond limit: **Loti i II-te: "Blerje Leter AS "Traktor" (3 kopje). Leter A4 "Traktor" (3 kopje)", me vlere 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e kater mije) Leke, pa TVSH, vene në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shogërise "Posta Shqiptare" sh.a. me procedure prokurimi Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar" ne forme elektronike, zhvilluar me date 20/11/2023, ora 10.00, ku pretendohet se. AK-ja ka kryer vleresim të karakterit siperfaqesor, duke kualifikuar oferta te pavlefshme qe nuk jane në perputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta per kualifikim sipas percaktimeve te DST-se, ju informojme si me poshte:**

1. Lidhur me pretendimet e ngritura ne ankesë **ku pretendoni** se operatori "Adel CO SHPK Formularin e vetëdeklarimit nuk e ka në përputhje me DST-ne, muk përmbush piken 2.3.2 te DST-se: ju informojme se:
- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë **ku pretendoni** se operatori "Adel CO" SHPK Formularin e vetëdeklarimit nuk e ka në përputhje me DST-ne. ju informojme se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në rrugë elektronike rezulton se Formularin e vetëdeklarimit është i paragitur nga operatori "Adel CO" SHPK është në përputhje të plotë me Formularin Standart të paraqitur në SHtojca 8, të DST-së ku jane deklaruar edhe të dhenat plotësuese të këtij operatori me staf, makineri e pajisje etj., duke përmbushur plotësisht pikën 2.1/a, të kriterëve të veçanta për kualifikim. Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë **ku pretendoni** se operatori "Adel CO" SHPK ka detyrime tatimore të pa paguara, ju informojmë se:

Nga shayrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në rrugë elektronike rezulton se nga operatori "Adel CO" SHPK janë dorëzuar:

- Vërtetim për pagim detyrimesh lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë me date 11.11.2023 me përmbajtjen:

Tatimpaguesi Adel CO" SHPK NIPT L22117021M Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor te papaguar deri më datën: 17.11.2023 ora 13:10:03

- Vërtetim Per Kontributet e Sigurimeve Shogerore e Shëndetësore per Tatimpaguesin E-SIG 02/a) per pagim detyrimesh lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane me date 11.11.2023 me përmbajtjen:

Tatimpaguesi Adel CO" SHPK NIPT L22117021M Rezulton se nuk ka asnjë detyrim apo gjobë për kontributet te papaguar deri më datën: 11.11.2023 ora 14:03:42

Perderisa keto ne SPE jane paragitur origjinale dhe me vule elektronike. për autoritetin kontraktor vlerësohen të rregullta.

Per sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson te përmbushur kete kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.2.1te DST-së, **ku parashikohet se:** Për te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 199% të vlerës limit të kontratës që prokurohet, ju informojme se:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor te dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori "Adel CO" SHPK, në përmbushje të pikës 2.2.1 të DST- rezulton se përveç dokumentacionit që ka paraqitur për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga ky operator, në mbështetje të pikës 4, të nenit 90 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit shoqëruar edhe me dokumentacion për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga operatori "NDERTIMI" shpk NIPT-i: K11325002C.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga sa theksuar më sipër rezulton se ky kriter përmbushet plotësisht nga ky operator.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.6 të DST-së dorëzimi i **mostrat të "Adel CO" SHPK**, ju informojmë se:

Autoriteti ynë kontraktor bazuar në pikën 6/a, të nenit 40, të VKM-së nr. 285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar, ka kërkuar si

dhe ka trajtuar mostrat e mallit (modelet), si informacion konfidencial tregtar dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi I mostrave të mallit (modelet), te dortara nga operatori "Adel CO" SHPK: vleresohen se i permbushin parametrat teknik te parashikuar ne DST dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejte

Për sa më sipër, ankesa e paraqitur nga ana Juaj, është shqyrtuar me shume vemendje nga Autoriteti yne Kontraktor por pretendime e ngritura në ankesë nuk vleresohen te drejta.

- **Me shkresën nr. 2080/22 prot. Datë 01.02.2024 (një kopje i është dërguar per dijeni edhe KPP-se), i është kthyer përgjigje operatorit ankimues "Inpress" SH.P.K. NUIS L52122014L, me përmbajtjen si vijon:**

Ne përgjigje të ankesës tuaj, paraqitur në KPP, lidhur me vlerësimin e ofertave të procedures se prokurimit REF-84246-10-18-2023, Loti i II-të: "Blerje Letër AS "Traktor" (3 kopje), Leter A4 "Traktor" (3 kopje)", me fond limit: Loti i II-të: "Blerje Letër AS "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)", me vlerë 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë, pa TVSH., vënë në dispozicion nga te ardhurat e vetë Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a., me procedurë prokurimi "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", në formë elektronike, zhvilluar me datë 20/11/2023, ora 10.00, ku pretendohet se, ofertat e ofertuara nga operatorët e kualifikuara InfoSoft Office SH.P.K. NUIS J62426002Q; "Marketing & Distribution" SH.P.K. NUIS J7212400IN DHE "Adel CO" SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim sipas përcaktimeve të DST-së dhe duhen skualifikuaj, ju informojmë si më poshtë:

1. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë se operatori ekonomik "InfoSoft Office" SH.P.K. NUIS J62426002Q, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët, ju informojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori "InfoSoft Office" SH.P.K. NUIS J624260020 si dhe bazuar në dokumentacionin shtesë të paraqitur nga ky operator pas kërkesës së bërë në SPE, për argumentim të ofertës ekonomike, në argumentim të anës ekonomike të ofertës ku deklarohet se si lidër në fushën e kancelarive zotëron kapacitet e nevojshme intelektuale financiare dhe përvojën e duhur për realizimin me sukses të kësaj kontrate, shoqëruar me kontrata të ndryshme furnizime me kancelarie me bazë letër, për AK-në është krijuar bindja se ky operator zotëron kapacitet e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate duke e vlerësuar si ofertë të rregullt.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të rregullt ofertën ekonomike dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se Skeda teknike e dorezuar nga Operatori "InfoSoft Office" SH.P.K. NUIS J624260020, ne përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-së, nuk përmbush parametrat teknik të kërkuar, ju informojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga operatori "**InfoSoft Office**" SHPK NUIS J624260020 në përmbushje të pikës 2.3.5 DST-se, rezulton se ka paraqitur kete dokumentacion:

- Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Algrafika Tirane I cili guranton suport per furnizimin e nevojshem te lendes se pare te prodhar nga prodhuesi Mitubishi HiTee Europe Gmbh" sipas specifikimeve teknike të kërkuara ne kete procedure, e cila mhane daren 15.11.2023
- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) léshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTee Europe Gmbh" ku deklarón si Distributor te Autorizuar "Algrafika" Tiranë si dhe deklarón furnizimin e këtij distributori me keto produkte (leter pa karbon)
- Skeden teknike (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi Letër AS "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhenave teknike të parashikuara në Shtojca 5, te DST-se me skeden teknike te paragitur nga Operatori "InfoSoft Office" SH.P.K. e leshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe Gmbh" të dhenat teknike te ofertuara ne tender rezultojnë të njejta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknik te këruara ne dokumentat standarte të tenderit.

Per sa me sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

II. Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë se operatori ekonomik "**Marketing & Distribution**" SH.P.K. NUIS J72124001N, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët, si dhe pretendimi se nuk ka përmbushur pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 të DST-së, ju informojmë se:

- Lidhur me pretendimet se oferta ekonomike është anomalisht e ulët, ju informojme se:

Referuar ofertave ekonomike të kualifikuara në këtë procedurë prokurimi si dhe bazuar ne formulën e miratuar në DST nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga përlllogaritjet e bëra rezultón se oferta e paragitur nga operatori ekonomik "Marketing & Distribution" SH.P.K NUIS J72124001N është më e lartë se kufiri i lejuar prej 85% të mesatares se ofertave te vlerësuara të rregullta.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të rregullt ofertën ekonomike dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se operatori "**Marketing & Distribution**" SH.P.K. NUIS J72124001N nuk përmbush pikat 2.2.1; 2.3.5 dhe 2.3.6 ën e DST-së: ju informojmë se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori **"Marketing & Distribution" SH.P.K.**, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST rezulton se ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Autorizim nga Distributori I Autorizuar "Grafotisak" Grude, Bosnjë Hercegovinë, I cili garanton support për furnizimin e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi Hitec Europe Gmbh" sipas specifikimeve teknike të kerkuara në këtë procedurë e cila mbante datën 24.08.2022.
- Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) leshuar nga prindes Menbishi HTec e cila mbane datën 24.08.2022 "Europe Gmbh" ku deklaroi si Distributor e Astorir Algrafika" Tirant si the deklaroi furnizimin e ketij distributori me keto produte dleter pa karbon
- Skeden teknike (Specifikimet teknike) te artikdve obleks prokurimi Leter AS "Traktor (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhen angleze dhe tt përktkyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhenave teknike 12 parashikuara në Shtojca S. t DST me skeden teknike të paragitur nga operatori "Marketing & Distribution" SHPK leshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe Gmbh" te dhenat teknike te ofertuara ne tender rezultojnë të njejta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknik te keruara ne dokumentat standarte të tenderit.

Per sa me siper, autoriteti yne kontraktor vlerëson te permbushura keto kriter dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejte

- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se kampionet e dorezuar nga operatori **"Marketing & Distribution" SH.P.K** NUIS J72124001N muk përmbushin plotësisht parametrat teknik të parashikuar ne DST. ju informojme se:

Autoriteti ynë kontraktor bazuar në piken 6/a, të nenit 40, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" indryshuar, ka kërkuar si dhe ka trajtuar mostrat e mallit (modelet), si informacion konfidencial tregtar dhe jane ne kontroll te autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i mostrave të mallit (modelet), te dorezuara nga operatori "Marketing & Distribution" SH.P.K. NUIS J72124001N; vlerësohen se i përmbushin parametrat teknik të parashikuar në DST dhe pretendimet e ngritura ne ankese vlerësohen jo të drejtë.

Për sa më sipër, ankesa e paraqitur nga ana Juaj, është shqyrtuar me shume vëmendje nga Autoriteti ynë Kontraktor por pretendime e ngritura në ankesë nuk vlerësohen te drejta.

III- Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë ku pretendoni se operatori **"Adel CO" SHPK** nuk përmbush pikat 2.2.1; 2.3.5 dhe 2.3.6 të DST-së: ju informojmë se:

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.2.1 të DST-së, ku parashikohet se: Për te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 199% të vlerës limit të kontratës që prokurohet, ju informojme se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori "Adel CO" SHPK, në përmbushje të pikës 2.2.1 të DST- rezulton se përveç dokumentacionit që ka paragatur për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga ky operator, në mbështetje të pikës 4, të nenit 90 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike" i ndryshuar ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit shogëruar edhe me dokumentacion për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga operatori "NDERTIMI" shpk NIPT-i: K11325002C

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga sa theksuar me sipër rezulton se ky kriter përmbushet plotësisht nga ky operator.

Për sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- *Lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.5 të DST-së ku pretendoni se Skeda teknike e dorëzuar nga Operatori "Adel CO" SHPK, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-se, nuk përmbush parametrat teknik të kërkuar, ju informojmë se:*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të dorëzuar në përmbushje të ofertës nga Operatori "Adel CO" SHPK, në përmbushje të pikës 2.3.5 të DST-së, rezulton se ka paragatur këtë dokumentacion:

- *Autorizim nga Distributori i Autorizuar "Algrafika" Tiranë, i cili garanton suport për furnizimin e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" sipas specifikimeve teknike të kërkuara në këtë procedurë.*
- *Autorizim prodhuesi (dokument autorizimi) lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" ku deklaroi si Distributor të Autorizuar "Algrafika" Tiranë si dhe deklaroi furnizimin e këtij distributori me këto produkte (leter pa karbon).*
- *Skeden teknike (Specifikimet teknike) të artikujve objekt prokurimi Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje), në gjuhën angleze dhe të përkthyer dhe noterizuar edhe në gjuhën shqipe.*

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave teknike të parashikuara në Shtojca 5, të DST-se me skeden teknike të paragatur nga Operatori "Adel CO" SHPK e lëshuar nga prodhuesi "Mitsubishi HiTec Europe GmbH" të dhënat teknike të ofertuara në tender rezultojnë të njëjta dhe përmbushen plotësisht me parametrat teknik të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Per sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson të përmbushur këtë kriter dhe ky pretendim i ngritur në ankesë vlerësohet jo i drejtë.

- Lidhur me përmbushjen e pikës 2.3.6 të DST-së dorëzimi i **mostrat të "Adel CO" SHPK, ju informojmë se:**

Autoriteti ynë kontraktor bazuar në pikën 6/a, të nenit 40, të VKM-së nr. 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” i ndryshuar, ka kërkuar si dhe ka trajtuar mostrat e mallit (modelet), si informacion konfidencial tregtar dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi I mostrave të mallit (modelet), të dorëzuara nga operatori “Adel Co” SHPK, vlerësohen se I përmbushin parametrat teknike të parashikuar në DST dhe pretendimet e ngritura në ankesë vlerësohen jo të drejta.

Për sa më sipër, ankesa e paraqitur nga ana juaj është shqyrtuar me shumë vëmendje nga ana e autoritetit kontraktor por pretendimet e ngritura në ankesë nuk vlerësohen të drejta.

II.9 Me shkresën datë 07.02.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 141/7 prot., datë 12.02.2024 me lëndë “Shpjegime shtesë referuar vendimit të KSHA-së nr. 2080/22 prot., datë 01.02.2024”, ka paraqitur argumente lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

II.10 Me shkresën me nr. 141/8 prot., datë 20.02.2024, me shkresën nr. 169/6 prot, datë 20.02.2024, si dhe me shkresën nr. 179/5, datë 20.02.2024 Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar informacion shoqërisë “Eko Studio Projekt” SHPK mbi koston apo tarifat e analizave të **një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje), një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**, për fushat e matjes për të cilat laboratorit është i akredituar konkretisht: gramatura dhe trashësia.

II.11 Në datën 23.02.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 141/9 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 172 prot., datë 22.02.2024 me objekt: “Kthim përgjigje shkresës me nr. 141/8 prot., datë 20.02.2024”. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit pjesë e fushës së akreditimit:

Letër – Karton – Brum Letre

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
5.	<i>Bardhësia</i>	<i>CIE</i>	<i>SSH ISO 11475:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
6.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
7.	<i>Lagështia</i>	<i>1-100%</i>	<i>SSH EN ISO 287:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

[...]

“Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi per njësi në lek pa TVSH</i>	<i>Cmimi total për kampion në lekë pa TVSH</i>
1.	<i>Gramatura A4</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>3</i>	<i>7920</i>	<i>23760</i>
2.	<i>Trashësia A4</i>	<i>Copë/një</i>	<i>3</i>	<i>5964</i>	<i>17892</i>

		<i>testim</i>			
3.	<i>Gramatura A5</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	7920	23760
4.	<i>Trashësia A4</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	5964	17892

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.12. Në datën 23.02.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 169/7 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 173 prot., datë 22.02.2024 me objekt: “*Kthim përgjigje shkresës me nr. 141/8 prot., datë 20.02.2024*”. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit pjesë e fushës së akreditimit:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
5.	<i>Bardhësia</i>	<i>CIE</i>	<i>SSH ISO 11475:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
6.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588- 1:2021</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
7.	<i>Lagështia</i>	<i>1-100%</i>	<i>SSH EN ISO 287:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

[...]

“Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi per njësi në lek pa TVSH</i>	<i>Cmimi total për kampion në lekë pa TVSH</i>
1.	<i>Gramatura A4</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	7920	23760
2.	<i>Trashësia A4</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	5964	17892
3.	<i>Gramatura A5</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	7920	23760
4.	<i>Trashësia A4</i>	<i>Copë/një testim</i>	3	5964	17892

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.13. Në datën 23.02.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 179/6 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 171 prot., datë 22.02.2024 me objekt: “Kthim përgjigje shkresës me nr. 141/8 prot., datë 20.02.2024”. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit pjesë e fushës së akreditimit:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
5.	<i>Bardhësia</i>	<i>CIE</i>	<i>SSH ISO 11475:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
6.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588- 1:2021</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
7.	<i>Lagështia</i>	<i>1-100%</i>	<i>SSH EN ISO 287:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471- 1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>

6.	Mbetje hirit	0.2% - 100 %	SSH ISO 2144:2019	ISO 186:2002
8.	Alkalinitetit	0.07-2 mol/kg CaCO ₃	SSH ISO 10716:2022	ISO 186:2002

[...]

“Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Cmimi per njësi në lek pa TVSH	Cmimi total për kampion në lekë pa TVSH
1.	Gramatura A4	Copë/një testim	3	7920	23760
2.	Trashësia A4	Copë/një testim	3	5964	17892
3.	Gramatura A5	Copë/një testim	3	7920	23760
4.	Trashësia A4	Copë/një testim	3	5964	17892

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.14. Me vendimin nr. 255/2024, datë 08.03.2024 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave letër A5 “traktor” (3 kopje) për specifikimet gramatura dhe trashësia, letër A4 “traktor” (3 kopje) për specifikimet gramatura dhe trashësia të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Inpress” SHPK, “Marketing Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
2. Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 249,912 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 172 prot., datë 22.02.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit

Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 13.03.2024 ora 12:00.

- 3. Në datën 13.03.2024 ora 12:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, “Marketing Distribution” SHPK” dhe “Infosoft Office” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.*
- 4. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.*
- 5. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijëni e mostrave.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.15 Me vendimin nr. 256/2024, datë 08.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave letër A5 “traktor” (3 kopje) për specifikimet teknike gramatura dhe trashësia, letër A4 “traktor” (3 kopje) për specifikimet teknike gramatura dhe trashësia, të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Marketing Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nga laboratorin e akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.*
- 2. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 166,608 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorëve ekonomikë “Marketing Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 173 prot., datë 22.02.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 13.03.2024 ora 12:00.*
- 3. Në datën 13.03.2024 ora 12:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK, “Marketing Distribution” SHPK” dhe “Infosoft Office” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.*
- 4. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.*

5. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijëni e mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.16 Me vendimin nr. 254/2024, datë 08.03.2024 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave letër A5 “traktor” (3 kopje) për specifikimet gramatura dhe trashësia, letër A4 “traktor” (3 kopje) për specifikimet gramatura dhe trashësia të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adel Co” SHPK dhe “Inpress” ShPK sipas metodës/standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorin e akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
2. Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 166,608 për testimin e mostrave të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK dhe “Inpress” SHPK lekë pa tvsh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 171 prot., datë 22.02.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 13.03.2024 ora 12:00.
3. Në datën 13.03.2024 ora 12:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “Adel Co” SHPK dhe “Inpress” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.
4. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
5. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijëni e mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17 Në datën 13.03.2024, në orën 12:00, si dhe në datën 13.03.2024, në orën 13:35, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt seanca dëgjimore, gjatë të cilës operatorët ekonomikë ankimes parashtruan pretendime paraprake.

II.17.1. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK parashtroi gjatë seancës dëgjimore, pretendimet paraprake të cilat janë parashtruar edhe në shkresën datë 12.03.2024 me lëndë “Kërkohe rishikimi i vendimeve të ndërmjetme të KPP-së nr. 254/2024 dhe 255/2024”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 141/13 prot., datë 13.03.2024 si vijon: *“Rishikimin e vendimit të ndërmjetëm të KPP nr. 254/2024 dhe 255/2024 duke ndryshuar dispozitivin e këtij vendimi: duke konsideruar të mirëqënë testimin (fletë analizat laboratorike/raport testimi nga laborator i certifikuar “Eko Studio Projekt” SHPK, përcjellë me anë të shkresës nr. 92 prot., datë 14.02.2023, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2694/1, datë 16.02.2023 që është kryer tashmë njëherë nga i vetmi laborator i akredituar në Republikën e Shqipërisë për mostrat e paraqitura nga OE Inpress shpk”.*

II.17.2 Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, gjatë seancës dëgjimore parashtroi pretendimet paraprake të cilat janë parashtruar edhe në shkresën datë 13.03.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 179/10 prot., datë 13.03.2024 si vijon: *“të njoftohemi dhe të jemi të pranishëm në procesin e matjes së mostrave, gjithashtu kërkojmë të merren masa që mostrat t’i kthehen kompanisë, pas përfundimit të procesit”.* Gjithashtu gjatë seancës dëgjimore, operatori ekonomik “Infosoft Office”, parashtroi pretendimin paraprak si vijon: *“[...]në vijim të pretendimeve të “Inpress” SHPK kërkoj të mos testohen mostrat, pasi është i njëjti furnitor i deklaruar në procedurën e vitit të kaluar[...].”*

II.17.3 Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK parashtroi pretendimet: *“[...] si mund të ketë siguri se mostrat janë të njëjtat mostra të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK”.*

II.18 Me vendimin nr. 284/2024, datë 18.03.2024 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procesit të testimit të mostrave të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 “Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A, moskryerjen e asnjë veprimi për testimin e mostrave nga Eko Studio Projekt SHPK deri në shqyrtimin e pretendimeve paraprake dhe marrjen e një vendimi të ndërmjetëm.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.19 Me shkresën nr.141/17prot., datë 19.03.2024 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua laboratorit Eko Projekt Studio me kërkesën për informacion si vijon: *“Kërkojmë nga ana juaj të na informoni se si zhvillohet procedura e kryerjes së matjeve laboratorike konform standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit,*

në përputhje me ligjin nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe nëse është e mundur pjesëmarrja e përfaqësuesve të operatorëve ekonomik ankimes në ambientet e laboratorit “Eko-Studio-Projekt” SHPK gjatë zhvillimit të procesit të testimit të mostrave”.

II.20. Me shkresën me nr. 336 prot., datë 27.03.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 141/18 prot., datë 29.03.2024, laboratori Eko Projekt Studio SHPK informon Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...]1. Laboratori Eko-Studio- Projekt realizon matje të parametrave kimike dhe fizik në zbatim të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është i akredituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit sipas standartit S SH ISO/IEC 17024:2017 për 82 elementë. Duke u bazuar në procedura standarde ndërkombëtare realizojmë edhe analiza të gramaturës në zbatim të standartit ISO 536/2019 “Letër dhe karton-përcaktimi i gramaturës” si dhe analizën e përcaktimit të trashësisë së letrës duke u bazuar në standartin ndërkombëtar ISO 534:2005 “Letër dhe karton-Përcaktimi i trashësisë”, densitetit dhe vëllimit specifik. 2. Në mbështetje standartit S SH ISO/IEC 17025:2017 konkretisht duke ju referuar pikës 7.3 për “Marrjen e mostrave”, laboratori në politikat e brendshme të sistemit të menaxhimit të procedurës teknike PT-04 “Procedurat për marrjen e mostrës/plani i kampionimit të mostrës” gjithashtu FO-15-02 “Formulari i aplikimit për kampion në laborator”, laboratori ndjek me përpikmëri të gjitha hapat e procedurës. Që në momentin kur në ambientet e laboratorit sillet një kampion nga klienti ose një person përgjegjës, laboratori ndjek një procedurë specifike për regjistrimin e mostrës duke përfshirë regjistrimin e kushteve duke përfshirë regjistrimin e kushteve në të cilën është transportuar dhe është sjellë mostra, të dhënat e regjistrimit dhe identifikimin e kushteve për pranimin e saj. Bazuar në PT-04 laboratori siguron që mostra të merret nga një person i trajnuar në procedurat e marrjes së mostrave. Duke ju referuar pikës 7.8.5 të standartit, personi që merr dhe regjistron mostrën në një protokoll me informacion të detajuar mbi të dhënat teknike për natyrën dhe origjinën e mostrës, pronarin e tij, datën dhe vendin e marrjes së mostravës, vendos kodin i cili pasqyrohet në FO-15-04 dhe cdo informacion tjetër të nevojshëm. Cdo devijim nga metoda e marrjes së mostrës gjithashtu shënohet në protokoll.

Një kopje e protokollit e firmosur nga klienti ose personi përgjegjës për sjelljen e mostrës dhe personi përgjegjës për marrjen e mostrës, shoqëron cdo mostër laboratorike të pranuar dhe një kopje tjetër i jepet klientit ose personit përfaqësues të tij. Në këtë mënyrë duke bërë regjistrimin e mostrës në një mënyrë konfidenciale dhe të koduar për personin përgjegjës që të analizojë mostrën dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë për klientin.

3. Në përputhje me procedurat dhe politikat e brendshme të sistemit të menaxhimit të laboratorit përkatësisht sipas PM-22 “Procedura për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen dhe transferimin e të dhënave elektronike” PO-05 “Politika e ruajtjes së informacionit konfidencial dhe e mbrojtjes së të dhënave elektronike”, PM-21 “Procedura e paanshmërisë së laboratorit”, PO-06 “Politika e paanshmërisë”, aksesit në mjediset e laboratorit është i limituar vetëm për stafin e autorizuar nga përfaqësuesi i larë i laboratorit.

4. Duke ju referuar pikës 4.1 dhe 4.2 të kapitullit 4 të S SH ISO/IEC 17025:2017, aktiviteti laboratorik duhet të ndërmerren në mënyrë të pavarur, të strukturuar, të menaxhuar dhe të paanshme në mënyrë që të garantojë rezultate të besueshme. Për sa është thënë më sipër, për

të ulur riskun e paanshmërisë, konfliktit të interesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit është e nevojshme që aktivitetet laboratorike të zhvillohen në mënyrë të pavarur në mënyrë që mos të ushtrohet presion mbi stafin e laboratorit përgjatë kryerjes së procedurave të analizimit.

5. Gjithashtu duke u referuar në procedurën e matjes mbi të cilën laboratoi mbështetet si dhe në zbatim të pikës 5 të standardit ISO 536:2019 “Letër dhe karton- përcaktimi i gramaturës”, aparati matës i nevojshëm për përcaktimin e gramaturës duhet të jetë i një saktësie matje të lartë. Aparatura që laboratori përdor për përcaktimin e gramaturës së letrës është peshorja analitike me rezolucion të prodhuesit “KERN”, e certifikuar dhe e kalibruar. Kjo pajisje lexon deri në 5 shifra pas presjes dhjetore për këtë arsye influencimi i faktorëve të jashtëm është i lartë dhe rrezikohen gabime në matje nga faktor të jashtëm. Për të shmangur këtë problematik amjenti ku janë instrumentet është një amjent i vecantë, i izoluar dhe gjatë procesit të matjes nuk lejohen më tepër se 1 specialist në dhomën e analizës pasi prezenca e disa personave do të conte në influencimin e instrumentit duke cuar në dhënien e një rezultati jo të saktë[...].”

II.21. Me vendimin nr. 352/2024, datë 08.04.2024 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

2. Të mos pranojë pretendimet paraprake të operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për mostestimin e mostrave për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023, me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
3. Të mos pranojë pretendimet paraprake të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për mostestimin e mostrave për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Të mos pranojë pretendimet paraprake të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për të qënë të pranishëm gjatë procesit të testimit të mostrave, nga laboratori “Eko Studio Projekt” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Të pranojë pretendimet paraprak të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për kthimin e mostrave në përfundim të procesit të testimit të tyre, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
6. Të mos pranojë pretendimet paraprake të operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.22. Në datën 17.04.2024 me shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion dhe transparencë mbi procedurën e vlerësimit me REF-84246-10-18-2023”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 179/11 prot., datë 19.04.2024, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur kërkesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik me pretendimet si më poshtë vijon:

- Për të ruajtur transparencën dhe barazinë në garë, kërkojmë që analiza të kryhet në një laborator të pa angazhuar më parë në procedura të ngjashme duke sekretuar

mostrat e paraqitura në mënyrë që të shmanget cdo ndikim i parregullt në procesin e vlerësimit. Nëse ky konfidencialitet sigurohet nuk gjejmë asnjë arsye përse të refuzohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë në procesin e vlerësimit. Në vijim sa më lart, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se, mostrat e paraqitura nga operatorët pranë jush (KPP dhe AK), janë jashtë paketimit standard, për një periudhë më të gjatë se 5 muaj, të ekspozuara ndaj pluhurit, lagështirës dhe prekjës nga anëtarët e komisionit apo persona që kanë qasje në dosje. Të gjithë këto elementë ndikojnë ndjeshëm në vetitë fizike të mostrës dhe ekziston një rrezik real të ndikojnë në vlerat e tyre. Sa më lart mund të jenë të vetmet arsye që ndikojnë në parametrat e produktit. Do të luteshim që laboratorët e përzgjedhur, të vihen në dijeni dhe për sa më lart, për të qënë sa më të saktë në vlerësimin e tyre ose për të marrë masa për tu pajisur me ekzemplarë të paketuara të të njëjtit produkt të cilin mund të zgjedhin në mënyrë rastësore nga magazinat tona.

Bazuar në sa më lart kërkojmë, përzgjedhjen e një laboratorit tjetër për vlerësimin si dhe të rishqyrtoni kërkesën tonë për pjesëmarrje në procesin e testimit.

II.23 Me vendimin nr. 420/2024, datë 25.04.2024 Komisioni I Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të mos pranojë kërkesën e shoqërisë “Infosoft Office” sh.p.k për përjashtimin laboratorit “Eko Studio Projekt” SHPK nga procesi i testimit të mostrave në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.24. Me anë të shkresës nr.250 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr.169/14 datë 29.04.2024, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, për shoqëritë “Infosoft Office” SHPK, “Inpress” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Adel Co” SHPK. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm rezultatet janë si më poshtë:

Për shoqërinë “Infosoft Office” SHPK:

Letër traktori A4 – SPS-PS-250

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja I	Faqja II	Faqja III	
1	Gramatura A4	ISO 536:2019	53.782	60.009	59.638	g/m ²
2	Trashësia A4	ISO 534:2005	68	72	72	µm

Letër traktori A5 – SPS-PS-250

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja IV	Faqja V	Faqja VI	
1	Gramatura A5	ISO 536:2019	53.694	59.770	60.800	g/m ²
2	Trashësia A5	ISO 534:2005	68	72	74	μm

Për shoqërinë “Inpress” SHPK:

Letër traktori A4 – SPS-PS-251

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja I	Faqja II	Faqja III	
1	Gramatura A4	ISO 536:2019	60.57	59.257	54.942	g/m ²
2	Trashësia A4	ISO 534:2005	72	75	55	μm

Letër traktori A5 – SPS-PS-251

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja IV	Faqja V	Faqja VI	
1	Gramatura A5	ISO 536:2019	57.469	63.4210	54.889	g/m ²
2	Trashësia A5	ISO 534:2005	68	72	75	μm

Për shoqërinë “Adel Co” SHPK:

Letër traktori A4 – SPS-PS-252

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja I	Faqja II	Faqja III	
1	Gramatura A4	ISO 536:2019	56.244	59.326	59.183	g/m ²
2	Trashësia A4	ISO 534:2005	74	74	74	μm

Letër traktori A5 – SPS-PS-252

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja VI	Faqja V	Faqja VI	
1	Gramatura A5	ISO 536:2019	56.832	59.780	60.033	g/m ²
2	Trashësia A5	ISO 534:2005	74	74	73	μm

Për shoqërinë “Marketing&Distribution” SHPK:

Letër traktori A4 – SPS-PS-253

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja I	Faqja II	Faqja III	
1	Gramatura A4	ISO 536:2019	55.165	69.250	54.038	g/m ²
2	Trashësia A4	ISO 534:2005	64	69	74	μm

Letër traktori A5 – SPS-PS-253

Nr.	Komponente te matur	Metoda	Të dhënat e matjes			Njësia
			Faqja VI	Faqja V	Faqja VI	
1	Gramatura A5	ISO 536:2019	52.806	56.128	54.191	g/m ²
2	Trashësia A5	ISO 534:2005	68	72	75	μm

II.24 Me shkresën nr.169/15 prot., datë 03.05.2024 Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK sqarim mbi rezultatet e testimit.

II.25 Me shkresën me nr. 391 prot., datë 07.05.2024 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr. 169/14 prot., datë 03.05.2024”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 169/16 prot., datë 09.05.2024, shoqëria “Eko Studio Projekt” SHPK ka paraqitur sqarime lidhur me kodin e sekretimit të regjistruar në laborator për cdo operator ekonomik.

II.26. Në datën 24.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, operatori ekonomik i interesuar “Inpress” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK.

II.27. Në datën 26.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, operatori ekonomik i interesuar “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK.

II.28. Në datën 26.01.2024, operatori ekonomik i interesuar “Marketing&Distribution” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK.

II.29. Në datën 26.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, operatori ekonomik i interesuar “Infosoft OFFice” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

II.30. Në datën 29.01.2024, operatori ekonomik i interesuar “Marketing&Distribution”, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

II.31. Në datën 29.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, operatori ekonomik i interesuar “Inpress” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.32. Në datën 30.01.2024, operatori ekonomik i interesuar “Adel Co” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.33. Në datën 30.01.2024, operatori ekonomik i interesuar “Adel Co” SHPK, ka paraqitur “Formularin e Paraqitjes së Argumenteve”, në të cilin parashtron pretendime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se “... Duke e njohur shumë mirë këtë firmë ne mendojmë se kjo firmë nuk ka kontrata të ngjashme në masën 38 % të fondit limit. Fjala punë të ngjashme do të thotë do të thotë në letër kimike për letër të vazhduar kimike në 3 kopje, gjë të cilën kjo firmë nuk e njuh këtë procedurë dhe prodhim, për arsye se në tregun e shtypshkrimeve kjo firmë është marrë vetëm me libra dhe regjistra...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.1.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit të lotit përkatës/shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisitë e mallrave të furnizuara.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisitë e mallrave të furnizuara.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Inpress” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Faturë tatimore nr. 69/2023, datë 08.05.2023, Faturë tatimore nr. 67/2021, datë 04.10.2021, Faturë tatimore nr. 326/2022, datë 29.12.2022, Faturë tatimore nr. 26/2022, datë 04.02.2022, Faturë tatimore nr. 41/2022, datë 01.04.2022, Faturë

tatimore nr. 77/2022, datë 03.06.2022, Faturë tatimore nr. 117/2022, datë 06.07.2022, Faturë tatimore nr. 133/2022, datë 29.07.2022, Faturë tatimore nr. 162/2022, datë 01.09.2022, Faturë tatimore nr. 268/2022, datë 08.11.2022, Faturë tatimore nr. 1/2023, datë 04.01.2023, Faturë tatimore nr. 20/2023, datë 09.02.2023, Faturë tatimore nr. 28/2023, datë 01.03.2023, Faturë tatimore nr. 44/2023, datë 23.03.2023, Faturë tatimore nr 61/2023, datë 29.04.2023, Faturë tatimore nr 78/2023, datë 25.05.2023, Faturë tatimore nr 85/2023, datë 23.06.2023, Faturë tatimore nr 95/2023, datë 31.07.2023, Faturë tatimore nr 97/2023, datë 04.08.2023, Faturë tatimore nr 101/2023, datë 21.08.2023, Faturë tatimore nr 33/2023, datë 29.06.2020, Faturë tatimore nr 46, datë 01.08.2020, Faturë tatimore nr 10, datë 03.09.2020, Faturë tatimore nr 16, datë 08.09.2020, Faturë tatimore nr 28, datë 22.09.2020, Faturë tatimore nr 37, datë 22.09.2020, Faturë tatimore nr 62, datë 14.10.2020, Faturë tatimore nr 67, datë 17.10.2020, Faturë tatimore nr 73, datë 26.10.2020, Faturë tatimore nr 75, datë 28.10.2020, Faturë tatimore nr 92, datë 26.11.2020, Faturë tatimore nr 93, datë 02.02.2020, Faturë tatimore nr 95, datë 09.12.2020, Faturë tatimore nr 100, datë 16.12.2020 me vlerë (16 800 lekë pa tvsh), Faturë tatimore nr 07, datë 05.01.2021, Faturë tatimore nr 19, datë 26.01.2021, Faturë tatimore nr 27, datë 04.02.2021, Faturë tatimore nr 29, datë 08.02.2021, Faturë tatimore nr 40/2023, datë 21.03.2023, Faturë tatimore nr 39/2023, datë 21.03.2023, Faturë tatimore nr 156/2022, datë 29.08.2022, Faturë tatimore nr 59, datë 04.02.2021, Faturë tatimore nr 60, datë 04.02.2021, Faturë tatimore nr 50, datë 16.09.2020, Faturë tatimore nr 310/2022, datë 20.12.2020, Faturë tatimore nr 11/2023, datë 24.01.2023, Faturë tatimore nr 13/2021, datë 07.07.2021, Faturë tatimore nr 53/2021, datë 15.09.2021, Faturë tatimore nr 89/2021, datë 22.10.2021, Faturë tatimore nr. 40, datë 09.07.2020, Faturë tatimore nr. 03/2021, datë 19.02.2021, Faturë tatimore nr. 12/2021, datë 06.07.2021, Faturë tatimore nr. 32/2021, datë 23.08.2021, Faturë tatimore nr. 102/2023, datë 21.08.2023, Faturë tatimore nr. 09/2023, datë 19.01.2023, Vertetim realizim kontrate nr. 1062 prot., datë 15.11.2019 me Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, me vlerë totale 163 280 lekë me TVsh, vërtetim realizimi kontrate me nr. 1644 prot., datë 20.08.2020 me postën shqiptare + kontratë bashkëngjitur, Faturë tatimore nr 6/2023, datë 11.01.2023, Faturë tatimore nr 23/2023, datë 16.02.2023, Faturë tatimore nr 36/2023, datë datë 13.03.2023, Faturë tatimore nr 87/2023, datë 27.06.2023, Faturë tatimore nr 141/2023, datë 02.11.2023, Faturë tatimore nr 125/2021, datë 13.12.2021, Faturë tatimore nr 134/2021, datë 20.12.2021, Faturë tatimore nr 139/2021, datë 31.12.2021, Faturë tatimore nr 5/2022, datë 11.01.2022, Faturë tatimore nr 9/2022, datë 14.01.2022, Faturë tatimore nr 11/2022, datë 17.01.2022, Faturë tatimore nr 12/2022, datë 18.01.2022, Faturë tatimore nr 13/2022, datë 19.01.2022, Faturë tatimore nr 14/2022, datë 20.01.2022, Faturë tatimore nr 15/2022, datë 21.01.2022, Faturë tatimore nr 27/2022, datë 08.02.2022, Faturë tatimore nr 29/2020 datë 22.09.2020, Faturë tatimore nr 18/2021 datë, 14.07.2021, Faturë tatimore nr 84/2021, datë 19.10.2021, Faturë tatimore nr 127/2022, datë 19.07.2022, Faturë tatimore nr 20 datë, 10.04.2020, Faturë tatimore nr 21, datë 21.04.2020, Faturë tatimore nr 22, datë 27.04.2020, Faturë tatimore nr 62/2023, datë 02.05.2023, Faturë tatimore nr 24/2023, datë 20.02.202, Faturë tatimore

nr 60/2022, datë 17.05.2022, Faturë tatimore nr 157/2023, datë 15.11.2023, Faturë tatimore nr 34/2021, datë 28.08.2021, Faturë tatimore nr 38/2021, datë 31.08.2021, Faturë tatimore nr 114/2021, datë 19.11.2021, Faturë tatimore nr 115/2021, datë 19.11.2021, Faturë tatimore nr 118/2021, datë 02.12.2021, Faturë tatimore nr 140/2021, datë 31.12.2021, Faturë tatimore nr 34, datë 01.07.2020, Faturë tatimore nr 42, datë 20.07.2020, Faturë tatimore nr 43, datë 24.07.2020, Faturë tatimore nr 23/2022, datë 01.02.2022, Faturë tatimore nr 31/2022, datë 01.03.2022, Faturë tatimore nr 54/2022, datë 04.05.2022, Faturë tatimore nr 74/2022, datë 01.06.2022, Faturë tatimore nr 118/2022, datë 08.07.2022, Faturë tatimore nr 160/2022, datë 01.08.2022, Faturë tatimore nr 225/2022, datë 03.10.2022, Faturë tatimore nr 252/2022, datë 26.10.2022, Faturë tatimore nr 279/2022, datë 22.11.2022, Faturë tatimore nr 6/2021, datë 16.03.2021, Faturë tatimore nr 53, datë 08.01.2021, Faturë tatimore nr 4/2021, datë 10.03.2021, Faturë tatimore nr 201/2022, datë 19.09.2022, Faturë tatimore nr 9/2021, datë 25.06.2021, Faturë tatimore nr 29, datë 02.06.2020, Faturë tatimore nr 13/ datë 19.01.2021, Faturë tatimore nr 97/2021, datë 03.11.2021, Faturë tatimore nr 50/2023, datë 11.04.2023, Faturë tatimore nr 63/2023, datë 02.05.2023, Faturë tatimore nr 7/2021, datë 22.04.2021, Faturë tatimore nr 52/2021, datë 13.09.2021, Faturë tatimore nr 78/2021, datë 12.10.2021, Faturë tatimore nr. 106/2021, datë 15.11.2021, faturë tatimore nr.130/2021, datë 16.12.2021, faturë tatimore nr. 10/2022, datë 17.01.2022, faturë tatimore nr. 28/2022, datë 11.02.2022, faturë tatimore nr. 39/2022, datë 17.03.2022, faturë tatimore nr. 47/2022, datë 14.04.2022, Faturë tatimore nr. 57/2022, datë 13.05.2022, faturë tatimore nr. 87/2022, datë 10.06.2022, faturë tatimore nr. 124/2022, datë 15.07.2022, Faturë tatimore nr 142/2022, datë 11.08.2022, Faturë tatimore nr 51/2021, datë 13.09.2021, Faturë tatimore nr 81/2021, datë 12.10.2021, Faturë tatimore nr 103/2021, datë 09.11.2021, Faturë tatimore nr 128/2021, datë 16.12.2021, Faturë tatimore nr 2/2022, datë 11.01.2022, Faturë tatimore nr 29/2022, datë 11.02.2022, Faturë tatimore nr 37/2022, datë 15.03.2022, Faturë tatimore nr 46/2022, datë 11.04.2022, Faturë tatimore nr 58/2022, datë 13.05.2022, Faturë tatimore nr 86/2022, datë 10.06.2022, Faturë tatimore nr 123/2022, datë 15.07.2022, Faturë tatimore nr 141/2022, datë 11.08.2022, Faturë tatimore nr 175/2022, datë 09.09.2022, Faturë tatimore nr 46/2023, datë 28.03.2023, Faturë tatimore nr 52/2023, datë 13.04.2023, Faturë tatimore nr 70/2023, datë 11.05.2023, Faturë tatimore nr 84/2023, datë 14.06.2023, Faturë tatimore nr 89/2023, datë 13.07.2023, Faturë tatimore nr 103/2023, datë 24.08.2023, Faturë tatimore nr 120/2023, datë 18.09.2023, Faturë tatimore nr 133/2023, datë 17.10.2023, Faturë tatimore nr 153/2023, datë 09.11.2023, Faturë tatimore nr 102/2023, datë 21.08.2023, Faturë tatimore nr 9/2023, datë 19.01.2023, Faturë tatimore nr 206, datë 21.10.2019, Faturë tatimore nr 16, datë 06.05.2020, Faturë tatimore nr 2/2021, datë 12.02.2021, Faturë tatimore nr 53, datë 08.01.2021, Faturë tatimore nr 82/2023, datë 08.06.2023, Faturë tatimore nr 144/2023, datë 06.11.2023, Faturë tatimore nr 93/2023, datë 24.07.2023, Faturë tatimore nr 204/2022, datë 21.09.2022, Faturë tatimore nr 238/2022, datë 13.10.2022, Faturë tatimore nr 241/2022, datë 19.10.2022 Faturë tatimore nr 296/2022, datë 06.12.2022, Faturë tatimore nr 302/2022, datë 09.12.2022, Faturë tatimore nr 317/2022, datë 22.12.2022, Faturë tatimore nr

319/2022, datë 22.12.2022, Faturë tatimore nr 99/2022, datë 14.06.2022, Faturë tatimore nr 126/2022, datë 18.07.2022, Faturë tatimore nr 203/2022, datë 21.09.2022, Faturë tatimore nr 282/2022, datë 24.11.2022, Faturë tatimore nr 287/2022, datë 02.12.2022, Faturë tatimore nr 143/2022, datë 12.08.2022, Faturë tatimore nr 102/2022, datë 15.06.2022, Faturë tatimore nr 111/2022, Faturë tatimore nr. 6/2023, datë 11.01.2023, faturë tatimore nr. 23/2023 datë 16.02.2023, Faturë tatimore 36/2023, datë 13.03.2023, Faturë tatimore 87/2023, date 27.06.2023, Faturë tatimore 141/2023, date 02.11.2023, Faturë tatimore 125/2021, date 13.12.2021, Faturë tatimore 134/2021, date 20.12.2021, Faturë tatimore 139/2021, datë 31.12.2021, Faturë tatimore 5/2022, date 11.01.2022, Faturë tatimore 9/2022, datë 14.01.2022, Faturë tatimore 11/2022, datë 17.01.2022, Faturë tatimore 12/2022, datë 18.01.2022, Faturë tatimore 13/2022, datë 19.01.2022, Faturë tatimore 14/2022, date 20.01.2022, Faturë tatimore 15/2022, datë 21.01.2022, Faturë tatimore 27/2022, datë 08.02.2022, Faturë tatimore 29/2020, datë 22.09.2020, Faturë tatimore 18/2021, datë 14.07.2021, Faturë tatimore 84/2021, date 19.10.2021, Faturë tatimore 127/2022, datë 19.07.2022, Faturë tatimore 20, datë 10.04.2020, Faturë tatimore 21, datë 21.04.2020, Faturë tatimore 22 datë 27.04.2020, Faturë tatimore 62/2023, datë 02.05.2023, Faturë tatimore 24/2023, datë 20.02.2020, Faturë tatimore 60/2022, datë 17.05.2022, Faturë tatimore 157/2023, datë 15.11.2023, Faturë tatimore 34/2021, datë 28.08.2021, Faturë tatimore 38/2021, datë 31.08.2021, Faturë tatimore 114/2021, date 19.11.2021, Faturë tatimore 115/2021, datë 19.11.2021, Faturë tatimore 118/2021, datë 02.12.2021, Faturë tatimore 140/2021, date 31.12.2021, Faturë tatimore 34, datë 01.07.2020, Faturë tatimore 42, date 20.07.2020, Faturë tatimore 43, date 24.07.2020, Faturë tatimore 23/2022, datë 01.02.2022, Faturë tatimore 31/2022, datë 01.03.2022, Faturë tatimore 54/2022, datë 04.05.2022, Faturë tatimore 74/2022, datë 01.06.2022, Faturë tatimore 118/2022, datë 08.07.2022, Faturë tatimore 160/2022, datë 01.08.2022, Faturë tatimore 225/2022, datë 03.10.2022, Faturë tatimore 252/2022, datë 26.10.2022, Faturë tatimore 279/2022, datë 22.11.2022, Faturë tatimore 6/2021, datë 16.03.2021, Faturë tatimore 53, date 08.01.2021, Faturë tatimore 4/2021, datë 10.03.2021, Faturë tatimore 201/2022, date 19.09.2022, Faturë tatimore 9/2021, datë 25.06.2021, Faturë tatimore 29, date 02.06.2020, Faturë tatimore 13, datë 19.01.2021, Faturë tatimore 97/2021, datë 03.11.2021, Faturë tatimore 50/2023, datë 11.04.2023, Faturë tatimore 63/2023, datë 02.05.2023, Faturë tatimore 7/2021, datë 22.04.2021, Faturë tatimore 52/2021, datë 13.09.2021, Faturë tatimore 78/2021, datë 12.10.2021, Faturë tatimore 106/2021, datë 15.11.2021, Faturë tatimore 130/2021, datë 16.12.2021, Faturë tatimore 10/2022, datë 17.01.2022, Faturë tatimore 28/2022, datë 11.02.2022, Faturë tatimore 39/2022, date 17.03.2022, Faturë tatimore 47/2022, datë 14.04.2022, Faturë tatimore 57/2022, datë 13.05.2022, Faturë tatimore 87/2022, datë 10.06.2022, Faturë tatimore 124/2022, datë 15.07.2022, Faturë tatimore 142/2022, datë 11.08.2022, Faturë tatimore 51/2021, date 13.09.2021, me vlerë 164,800 lekë pa tvsh, Faturë tatimore 81/2021, datë 12.10.2021, me vlerë 160,415 lekë pa tvsh, Faturë tatimore 103/2021, datë 09.11.2021, Faturë tatimore 128/2021, datë 16.12.2021, Faturë tatimore 2/2022, datë 11.01.2022, Faturë tatimore 29/2022, datë 11.02.2022, Faturë tatimore 37/2022, date 15.03.2022, Faturë tatimore 46/2022,

datë 11.04.2022, Faturë tatimore 58/2022, datë 13.05.2022, Faturë tatimore 86/2022, datë 10.06.2022, Faturë tatimore 123/2022, datë 15.07.2022, Faturë tatimore 141/2022, datë 11.08.2022, Faturë tatimore 175/2022, datë 09.09.2022, Faturë tatimore 46/2023, datë 28.03.2023, Faturë tatimore 52/2023, datë 13.04.2023, Faturë tatimore 70/2023, datë 11.05.2023, Faturë tatimore 84/2023, datë 14.06.2023, Faturë tatimore 89/2023, datë 13.07.2023, Faturë tatimore 103/2023, datë 24.08.2023, Faturë tatimore 120/2023, datë 18.09.2023, Faturë tatimore 133/2023, datë 17.10.2023, Faturë tatimore 153/2023, datë 09.11.2023, Faturë tatimore 102/2023, datë 21.08.2023, Faturë tatimore 9/2023, datë 19.01.2023, Faturë tatimore 206, datë 21.10.2019, Faturë tatimore 16, datë 06.05.2020, Faturë tatimore 2/2021, datë 12.02.2021, Faturë tatimore 53, datë 08.01.2021, Faturë tatimore 82/2023, datë 08.06.2023, Faturë tatimore 144/2023, datë 06.11.2023, Faturë tatimore 93/2023, datë 24.07.2023, Faturë tatimore 204/2022, datë 21.09.2022, Faturë tatimore 238/2022, datë 13.10.2022, Faturë tatimore 241/2022, datë 19.10.2022, Faturë tatimore 296/2022, datë 06.12.2022, Faturë tatimore 302/2022, datë 09.12.2022, Faturë tatimore nr 317/2022, datë 22.12.2022, Faturë tatimore 319/2022, datë 22.12.2022 me vlerë 2,112 lekë pa tvsh, Faturë tatimore 99/2022, datë 14.06.2022, Faturë tatimore 126/2022, datë 18.07.2022, Faturë tatimore 203/2022, datë 21.09.2022, Faturë tatimore 282/2022, datë 24.11.2022, Faturë tatimore 287/2022, datë 02.12.2022, Faturë tatimore 143/2022, datë 12.08.2022, Faturë tatimore 102/2022, datë 15.06.2022 Faturë tatimore 111/2022, datë 24.06.2022, Faturë tatimore 144/2022, datë 17.08.2022, Faturë tatimore 149/2022, datë 19.08.2022, Faturë tatimore 270/2022, datë 10.11.2022, Faturë tatimore 281/2022, datë, 24.11.2022, Faturë tatimore 322/2022, datë 27.12.2022, Faturë tatimore 331/2022, datë 30.12.2022, Faturë tatimore 122/2022, datë 14.07.2022, Faturë tatimore 185/2022, datë 13.09.2022, Faturë tatimore 286/2022, datë 30.11.2022, Faturë tatimore 332/2022, datë 30.12.2022, Faturë tatimore 62/2022, datë 20.05.2022, Faturë tatimore 138/2022, datë 03.09.2022, Faturë tatimore 110/2021, datë 19.11.2021, Faturë tatimore 111/2021, datë 19.11.2021, Faturë tatimore 116/2021, datë 22.11.2021, Faturë tatimore 121/2021, datë 06.12.2021, Faturë tatimore 122/2021, datë 09.12.2021

III.1.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.4. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi i rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, pika. **2.3.1** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit të lotit përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore, ku vërteton se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore dhe subjekte private. si dhe duke hequr nga përlllogaritja faturat të cilat nuk ishin të ngjashme me objektin e prokurimit (si adeziv, tonera, kancelari, shtypshkrime, shërbime printimi etj.), nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, KPP konstaton se këto të fundit përmbushin vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor për furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se “[...]Në skedën teknike të paraqitur nga kjo firmë nuk janë të gjitha parametrat sipas specifikimeve teknike. Më konkretisht në dokumentet e tenderit është kërkuara “patejdukshmëri” kurse në skedën teknike kjo firmë i është përgjigjur tejudkshëmrisë, gjë për të cilën kjo firmë nuk plotëson dokumentet e tenderit pasi “tejudkshëmria” me “patejdukshëmrinë” janë dy të kundërta”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë është reaktivuar testimi i mostrave pretendimi mbi verifikimin e skedave teknike nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se: “[...]Në DST është shprehur qartë që

të gjithë dokumentet duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes i miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të gjitha dokumentet noterohen, ku cdo faqe noterohet nga noterja dhe në bazë të përkthimit që bën përkthyesi ku në cdo faqe vendos firmën dhe vulën e tij. Ky dokument me firmë dhe vulë nga përkthyesi noterohet nga noteri duke i paraqitur të gjitha dokumentet përkatëse. Ne ju garantojmë që kjo firmë nuk e ka bërë këtë procedurë për arsye se dhe një vit më parë, nuk i ka të vulosura faqe më faqe nga përkthyesi sipas ligjit...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret Veçanta të Kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Inpress” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin “Deklaratë zyrtare”, datë 01.11.2023 lëshuar nga *Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.)* nëpërmjet kësaj shkrese konfirmojmë se, *Office Paper SHPK...është klienti ynë ekskluziv, i drejtpërdrejtë si dhe distributori ynë i besuar – për lëndën e parë “”Letër kimike (mbështjelljet – CF, CFB, CB) e nevojshme për prodhimin e produktit “Letër vetëkopjuese (CB, CFB, CF)”,- Format A5 dhe Format A4-në Shqipëri (informacioni i letrës TDS bashkëngjitur), shoqëruar me Skedë teknike Letër Kopjuese pa Karbon Format A4, A5, CB – E veshur mbrapa (kopja e parë); CFB – E veshur para dhe pas (kopja e dytë), CF – e veshur para (kopja e tretë). (në gjuhën anglisht dhe shqip), shoqëruar me Vërtetim Njësie me Originalin me nr. Rep. 8971, date 14.11.2023 dhe vërtetim përkthimi me nr. Rep 8970, datë 14.11.2023.*

III.3.3. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti

kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

III.3.5. Në nenin 62, pika 1 “Kompetencat e noterit” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” parashikohet se: *“i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”.*

Në nenin 129 “Vërtetimi i njësisë me origjinalin” parashikohet se: *“1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre.*

2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.

3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal.

4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit.

5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji”

Në nenin 138 “Ankimi për pavlefshmërinë e akteve ose veprimeve noteriale” parashikohet se : *“1. Pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohej nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale.*

2. Në vendimin e gjykatës që deklaron të pavlefshëm një akt noterial, urdhërohet zyra përkatëse e noterisë të bëjë shënimet e duhura në origjinalin e aktit, i cili ndodhet i depozituar në këtë zyrë.

III.3.6. Në pikën 14 të Udhëzimit nr. 23, datë 07.12.2020 “Për evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale”, seksioni “I. Evidentimi, administrimi dhe ruajtja e akteve dhe dokumenteve noteriale” parashikohet se: *“14. Në rastin e vërtetimit të kopjes me dokumentin origjinal, në arkivin e noterit ruhet një kopje e tij. Noteri bën shënimin “Vërtetohet se njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal.”. Vërtetimi i kopjes me origjinalin bëhet me dokument të veçantë. Vërtetimi i*

njesisë së kopjeve ose shkurtimeve me origjinalin është i parregullt, kur teksti, pjesë të tij ose shkronja të veçanta të kopjes së vërtetuar të dokumentit, nuk janë të lexueshme.

III.3.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik Adel Co SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, konkretisht - Dokumentin “Deklaratë zyrtare”, datë 01.11.2023 lëshuar nga *Goodwill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.)* nëpërmjet kësaj shkrese konfirmojmë se, *Office Paper SHPK...është klienti ynë ekskluziv, i drejtpërdrejtë si dhe distributori ynë i besuar – për lëndën e parë “”Letër kimike (mbështjelljet – CF, CFB, CB) e nevojshme për prodhimin e produktit “Letër vetëkopjuese (CB, CFB, CF)”,- Format A5 dhe Format A4-në Shqipëri (informacioni i letrës TDS bashkëngjitur), shoqëruar me Skedë teknike Letër Kopjuese pa Karbon Format A4, A5, CB – E veshur mbrapa (kopja e parë); CFB – E veshur para dhe pas (kopja e dytë), CF – e veshur para (kopja e tretë). (në gjuhën anglisht dhe shqip), shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin me nr. Rep. 8971, date 14.11.2023 dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 8970, datë 14.11.2023, konstatoi se dokumentacioni i mësipërm është i shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin, e cila përmban të dhëna si: nr. REP, data, të dhënat e noterit (emri, mbiemri, adresa) si dhe pullë tarife e paguar.*

Në rastin konkret, KPP konstaton, se kemi të bëjmë me Vërtetim njësie me origjinalin, ku sipas udhëzimit të sipërcituar në pikën 14, parashikohet se *“Në rastin e vërtetimit të kopjes me dokumentin origjinal, në arkivin e noterit ruhet një kopje e tij. Noteri bën shënimin “Vërtetohet se njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal.”. Vërtetimi i kopjes me origjinalin bëhet me dokument të veçantë. Vërtetimi i njesisë së kopjeve ose shkurtimeve me origjinalin është i parregullt, kur teksti, pjesë të tij ose shkronja të veçanta të kopjes së vërtetuar të dokumentit, nuk janë të lexueshme”.*

KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon se, zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë se, operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, operatori ekonomik me dokumentacionin e dorëzuar përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se *“..në ditën dhe orën e hapjes së tenderit nga kjo firmë janë paraqitur kampionet, ku dukej me sy të lirë që modelet e këtyre*

firmave ishin shumë herë më të hollë se sa kërkohej në specifikimet teknike....duke qënë të bindur se kampionet e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara, kërkojmë që të bëhen analiza nga një laborator i akredituar....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, është parashikuar:

2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje)**) dhe **një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**).**

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 8, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.4.2. Në Shtojcën 5, “Specifikimet teknike”, të dokumentave të tenderit është parashikuar si vijon:

***Specifikimet teknike për
“Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”***

- ***Letër A5 "Traktor" në 3 kopje***
 - ***Format A5, me përmasat e jashtme 234±5mm x 152±5mm, letër vetkopjuese.***
 - ***Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.***
 - ***Me biroshje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.***

- *Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.*

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

Pesha : 58 + - 4% g/m²

Trashësia: 80+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lëmueshmeria > 15 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Patejdukshmëria > 79 %

Ndricimi 102 + - 3 %

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

Pesha: 58 + - 4% g/m²

Trashësia 78+ - 5 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 30 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

Faqja tretë- kopja para CF coated front

Pesha: 60 + - 4% g/m²

Trashësia: 73+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 mN

<i>Lëmueshmeria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

- Letër A4 "Traktor" në 3 kopje

- *Format A4 me përmasat e jashtme: 234±5mm x 304± 5mm, letër vetkopjuese,*
- *Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.*
- *Me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.*
- *Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.*

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

<i>Pesha:</i>	<i>58 + - 4% g/m²</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>80+ - 6 μm</i>
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>
<i>Lemueshmeria</i>	<i>> 15 Bekk S</i>
<i>Lageshtira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Patejdukshmëria</i>	<i>> 79 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>102 + - 3 %</i>

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

<i>Pesha:</i>	<i>58 + - 4% g/m²</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>78+ - 5 μm</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>
<i>Lëmueshmëria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>

Lagështira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

Faqja tretë- kopja para CF coated front

Pesha: 60 + - 4% g/m²

Trashësia: 73+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 mN

Lëmueshmëria > 30 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

III.4.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4 Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.4.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.4.6. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3.6 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)). Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

III.4.7 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik Adel Co SHPK, referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostra për artikujt letër traktor A4 dhe letër traktor A5, ku secila nga fijet e letrës përbëhet nga tre kopje, faqja e parë, e dytë dhe e tretë.

Sa më sipër, referuar pretendimeve e operatorit ekonomik Adel Co SHPK për testimin e këtyre mostrave, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, në mbështetje të pikës 5 të nenit 115 të LPP, KPP gjykoi të

domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të këtyre mostrave. Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër për produktet Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5 me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit dhe informacion mbi kostot dhe tarifat e analizave të këtyre produkteve.

Me anë të shkresës nr. 172 prot., datë 22.02.2024, protokolluar pranë KPP me nr. 141/9 prot., datë 23.02.2024 shoqëria “Eko-Studio Projekt” SHPK bën me dije analizat për të cilat është i akredituar për të kryer, si dhe tarifat për kryerjen e tyre.

Në datën 08.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 255/2024, nr. 254/2024, nr. 256/2024 për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Infosoft Office”, SHPK “Marketing & Distribution” SHPK, “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK dhe, konkretisht të mostrave të dorëzuar nga këto të fundit për artikujt Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5.

Në datën 13.03.2024, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt një seancë dëgjimore, me përfaqësues të shoqërisë “Adel Co” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, “Inpress” SHPK, “Infosoft Office” SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, u përzgjodhën mostrat që do ti nënshtroheshin testimit.

Me anë të shkresës nr.250 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr.169/14 datë 29.04.2024, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, për shoqëritë “Infosoft Office” SHPK, “Inpress” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, dhe “Adel Co” SHPK. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm rezultatet janë si më poshtë:

Për shoqërinë “Inpress” SHPK: Gramatura për letër A4, Faqja e parë 60.57 g/m², Faqja e dytë 59.257 g/m² dhe Faqja e tretë 54.942 g/m², Trashësia: Faqja I 72 µm, Faqja II 75 µm, Faqja III 55 µm, ndërsa për letër A5 Faqja e parë 57.469 g/m², Faqja e dytë 63.4210 g/m² dhe Faqja e tretë 54.889 g/m², Trashësia: Faqja I 68 µm, Faqja II 72 µm, Faqja III 75 µm,

III.4.8. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha:*

58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, *Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha* 58 + - 4% g/m²; *Trashësia:* 78+ - 5 µm, *Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha:* 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6 µm (marzhi i gabimit të vetë aparatit është 0.1 g), ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha:* 58 + - 4% g/m²; *trashësia* 80+ - 6 µm, *Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha* 58 + - 4% g/m²; *Trashësia:* 78+ - 5 µm, *Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha:* 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6.

Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezultoi se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi goftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes "Adel CO" SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Adel CO" SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK me arsyetimin se *"...në ditën dhe orën e hapjes së tenderit nga kjo firmë janë paraqitur kampionet, ku dukej me sy të lirë që modelet e këtyre firmave ishin shumë herë më të hollë se sa kërkohej në specifikimet teknike....duke qënë të bindur se kampionet e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara, kërkojmë që të bëhen analizanga një laborator i akredituar...."*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e tenderit "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 2.3.6 "Kapaciteti teknik", është parashikuar:

2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje)**) dhe **një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**).**

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 8, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e

parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.6.2. Në Shtojcën 5, “Specifikimet teknike”, të dokumentave të tenderit është parashikuar si vijon:

**Specifikimet teknike për
“Letër A5 ”Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”**

- **Letër A5 ”Traktor” në 3 kopje**
 - **Format A5, me përmasat e jashtme $234\pm 5\text{mm} \times 152\pm 5\text{mm}$, letër vetkopjuese.**
 - **Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.**
 - **Me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.**
 - **Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.**

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

Pesha : $58 + - 4\% \text{ g/m}^2$

Trashësia: $80+ - 6 \mu\text{m}$

Ashpërsia në përkulje: $MD > 11 \text{ mN}$

Ashpërsia në përkulje: $CD > 3 \text{ mN}$

Lëmueshmeria $> 15 \text{ Bekk S}$

Lagështira relative $50+ - 8 \%$

Patejdukshmëria $> 79 \%$

Ndricimi $102 + - 3 \%$

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

Pesha: $58 + - 4\% \text{ g/m}^2$

Trashësia $78+ - 5 \mu\text{m}$

<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>
<i>Lemueshmeria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lageshtira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

Faqja tretë- kopja para CF coated front

<i>Pesha:</i>	<i>60 + - 4% g/m2</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>73+ - 6 μm</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 12 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 4 mN</i>
<i>Lëmueshmeria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

- Letër A4 "Traktor" në 3 kopje

- *Format A4 me përmasat e jashtme: 234±5mm x 304± 5mm, letër vetkopjuese,*
- *Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.*
- *Me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.*
- *Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.*

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

<i>Pesha:</i>	<i>58 + - 4% g/m2</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>80+ - 6 μm</i>
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>

<i>Lemueshmeria</i>	<i>> 15 Bekk S</i>
<i>Lageshtira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Patejdukshmëria</i>	<i>> 79 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>102 + - 3 %</i>

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

<i>Pesha:</i>	<i>58 + - 4% g/m²</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>78+ - 5 μm</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>
<i>Lëmueshmëria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

Faqja tretë- kopja para CF coated front

<i>Pesha:</i>	<i>60 + - 4% g/m²</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>73+ - 6 μm</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 12 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 4 mN</i>
<i>Lëmueshmëria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

III.6.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.6.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.6.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin

publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.6.6. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, të modifikuara nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.6 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvritit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)). Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

III.6.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik akimues, referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik "Marketing& Distribution" SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostra për artikujt letër traktor A4 dhe letër traktor A5, ku secila nga fijet e letrës përbëhet nga tre kopje, faqja e parë, e dytë dhe e tretë.

Sa më sipër, referuar pretendimeve e operatorit ekonomik ankimues për testimin e këtyre mostrave, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, në mbështetje të pikës 5 të nenit 115 të LPP, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të këtyre mostrave.

Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër për produktet Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5 me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit dhe informacion mbi kostot dhe tarifat e analizave të këtyre produkteve.

Me anë të shkresës nr. 172 prot., datë 22.02.2024, protokolluar pranë KPP me nr. 141/9 prot., datë 23.02.2024 shoqëria "Eko-Studio Projekt" SHPK bën me dije analizat për të cilat është i akredituar për të kryer, si dhe tarifat për kryerjen e tyre.

Në datën 08.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr.254/2024, nr. 255/2024, nr. 256/2024 për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë "Infosoft Office", SHPK "Marketing & Distribution" SHPK, "Inpress" SHPK, "Adel Co" SHPK dhe, konkretisht të mostrave të dorëzuar nga këto të fundit për artikujt Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5.

Në datën 13.03.2024, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt një seancë dëgjimore, me përfaqësues të shoqërisë "Adel Co" SHPK, "Marketing & Distributin" SHPK, "Inpress" SHPK, "Infosoft Office" SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, u përzgjedhën mostrat që do të nënshtroheshin testimit.

Me anë të shkresës nr.250 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr.169/14 datë 29.04.2024, Laboratori "Eko – Studio – Projekt" SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik "Raport Testimi" të mostrave, për shoqëritë "Infosoft Office" SHPK,

“Inpress” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, dhe “Adel Co” SHPK. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm rezultatet janë si më poshtë:

Për shoqërinë “Marketing & Distribution” SHPK: Gramatura për letër A4, Faqja e parë 55.165 g/m², Faqja e dytë 69.250 g/m² dhe Faqja e tretë 54.038 g/m², Trashësia: Faqja I 64 µm, Faqja II 69 µm, Faqja III 74 µm, ndërsa për letër A5 Faqja e parë 52.806 g/m², Faqja e dytë 56.128 g/m² dhe Faqja e tretë 54.191 g/m², Trashësia: Faqja I 68 µm, Faqja II 72 µm, Faqja III 75 µm,

III.6.8. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha 58 + - 4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm, Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6 µm*, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha 58 + - 4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm , Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6.*

Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Adel CO” SHPK qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Adel – CO” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, gjykojmë, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK nuk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik rrjedhimisht pretendimet e tjera të

ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: *“Dokumentacioni që kjo firmë disponon që e ka paraqitur edhe një vit më parë, bazuar në pikën 2.3.5 së bashku me autorizimin e prodhuesit të paraqitet edhe skeda teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar, por ne mendojmë që skeda teknike nuk është sipas specifikimeve teknike në DST. Pra, parametrat në skedën teknike nuk janë sipas kërkesave në DST por janë të ndryshme, konkretisht:- Po të kemi parasysh specifikimet teknike ne mendojmë që firma “Infosoft” shpk nuk i është përgjigjur parametrat të ndricimit të kërkuar në specifikimet teknike, element shumë thelbësor duke ditur që letra traktor në tre kopje në bazë të ndricimit që do të ketë letra do jetë cilësia e shtypit. Sic theksuam mendojmë që kjo firmë ka paraqitur “shkëlqimin” e letrës në vend të ndricimit.....2) ...Skeda teknike duhet të paraqitet për të dyja llojet e letrës A4 dhe A5. Skeda teknike duhet të paraqitet për të dyja llojet e letrës, ku sipas kësaj pike firma Infosoft Office duhet të kishte paraqitur si për letrën A4 dhe për letrën A5 specifikimet teknike me vete, gjë të cilën ne mendojmë se kjo firmë nuk e ka realizuar....b) Duke iu referuar kësaj pike që cituam më lart krahas skedës teknike duhet të paraqitet edhe autorizim prodhuesi...Autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga firma “Infosoft Office” SHPK nuk është i saktë për arsye se në autorizimin e prodhuesit nga algrafika thuhet që ofrohet lëndë e parë letër kimuke dhe duke ditur që firma Infosoft Office nuk është shtypshkronjë duhet të ishte theksuar në autorizimin e prodhuesit që firma Algrafika ofronte letër traktor [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,*

III.8.1. Në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit pika 2.3.5 e “Kapacitetit teknik”, është kërkuar si më poshtë:

2.3.5. Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

III.8.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokument autorizimi datë 11.08.2022 lëshuar nga shoqëria Mitsubishi Hitec Paper për shoqërinë Algrafika SHPK me përmbajtje si më poshtë: *“Në Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, me adresë Niedernholz 23, 33699 Bielefeld Gjermani, që jemi prodhues zyrtar të letrës pa karbon, me fabrika në Gjermani, deklarojmë se furnizojmë Algrafika shpk, autostrada Tr-DR Km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me produkte të prodhuara në fabrikat tona. Algrafika shpk është distributori ynë i autorizuar në shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH për tregun shqiptar, në sektorin privat dhe publik.”*, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5954, datë 03.11.2022, me firmë dhe vulë noteriale si dhe dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5955, datë 03.11.2022;
- Skede teknike faqja e tretë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5543, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5547, datë 15.11.2023;
- Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5544, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi me nr. Rep 5546, datë 15.11.2023.
- Skede teknike faqja e parë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB e shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep 5542, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi me nr. Rep 5548, datë 15.11.2023
- Skedë teknike “Infosoft Office” SHPK, specifikimet teknike letër e vazhduar (traktor) A4, letër e vazhduar (traktor) A5,
- Autorizim i lëshuar nga distributori I autorizuar nga prodhuesi Algrafika shpk, datë 15.11.2023 më përmbajtje si vijon:.....*kompania algrafika shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, kashar, tiranë, në cilësinë e distributorit të autorizuar të prodhuesit të letrës kimike “Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH”, autorizon shoqërinë infosoft office shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri që të prodhojë dhe të ofertojë produktet për procedurën Loti II-të: “Blerje letër A5 traktor (3 kpje), letër A4 “Traktor” (3 kopje) me numër REF-84246-10-18-2023 që do të zhvillohet me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor Sha posta Shqiptare. Garantojmë suport të plotë ndaj Infosoft office shpk me gjithë furnizimet e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi “Mitsubishi Hitec Paper europe Gmb” sipas specifikimeve teknike të kërkuara,...*”

III.8.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.8.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.8.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në interpretim të kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka ndarë dy momente në përmbushje të tij, konkretisht “Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.”

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Dokument autorizimi datë 11.08.2022 lëshuar nga shoqëria Mitsubishi Hitec Paper për shoqërinë Algrafika SHPK me përmbajtje si më poshtë: “Në Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, me adresë Niedernholz 23, 33699 Bielefeld Gjermani, që jemi prodhues zyrtar të letrës pa karbon, me fabrika në Gjermani, deklarojmë se furnizojmë Algrafika shpk, autostrada Tr-DR Km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me produkte të prodhuara në fabrikat tona. Algrafika shpk është distributori ynë i autorizuar në shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH për tregun shqiptar, në sektorin privat dhe publik.”, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5954, datë 03.11.2022, me firmë dhe vulë noteriale si dhe dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5955, datë 03.11.2022;Skede teknike faqja e tretë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5543, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5547, datë 15.11.2023;Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF;Skede teknike faqja e parë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB, Skedë teknike “Infosoft Office” SHPK, specifikimet teknike letër e vazhduar (traktor) A4, letër e vazhduar (traktor) A5,

Autorizim i lëshuar nga distributori I autorizuar nga prodhuesi Algrafika shpk, datë 15.11.2023 më përmbajtje si vijon: “.....kompania algrafika shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, kashar, tiranë, në cilësinë e distributorit të autorizuar të prodhuesit të letrës kimike “Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH”, autorizon shoqërinë infosoft office shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri që të prodhojë dhe të ofertojë produktet për procedurën Loti II-të: “Blerje letër A5 traktor (3 kpje), letër A4 “Traktor” (3 kopje) me numër REF-84246-10-18-2023 që do të zhvillohet me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor Sha posta Shqiptare. Garantojmë suport të plotë ndaj Infosoft office shpk me gjithë furnizimet e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi “Mitsubishi Hitec Paper europe Gmb” sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ... Pra, sa më sipër, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me anë të dokumentacionit të mësipërm vërteton se do të furnizohet me produktin e lëndë e parë “letër kimike” nga shoqëria Algrafika, e cila është distributori për Shqipërinë, nga shoqëria prodhuese Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH.

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4

“Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku *me skedën teknike të produktit të ofertuar*, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Ndërsa operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin *skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor*, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në përmbushje të kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, të modifikuar, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke qenë së është prodhues i produktit final letrës traktor, ka paraqitur autorizimin e distributorit për lëndën e parë për prodhimin e letrës, nga Algrafika SHPK, si dhe skedën teknike për letrën e përdorur, të lëshuar nga prodhuesi i lëndës së parë Mitsubishi Hitec Paper europe GmbH.

Lidhur me pretendimin se “*Skeda teknike duhet të paraqitet për të dyja llojet e letrës A4 dhe A5. Skeda teknike duhet të paraqitet për të dyja llojet e letrës, ku sipas kësaj pike firma Infosoft Office duhet të kishte paraqitur si për letrën A4 dhe për letrën A5 specifikimet teknike me vete, gjë të cilën ne mendojmë se kjo firmë nuk e ka realizuar*”, nga verifikimi i skedës teknike Komsioni konstaton se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur skedën teknike për *letrën pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH*, duke qënë se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është prodhues i produktit final letrës traktor me skedën e dorëzuar ai përmbush këtë pikë të kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.5.

III.8.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për verifikimin e skedave teknike të dorëzura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, gjykojmë, se për sa kohë është reaktuar testimi i mostrave pretendimi mbi verifikimin e skedave teknike nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Adel CO” SHPK nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se “*..në ditën dhe orën e hapjes së tenderit nga kjo firmë janë paraqitur kampionet, ku dukej me sy të lirë që modelet e këtyre firmave ishin shumë herë më të hollë se sa kërkohej në specifikimet teknike....duke qënë të bindur se kampionet e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara, kërkojmë*

që të bëhen analiza nga një laborator i akredituar....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, është parashikuar:

2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)).

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 8, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.9.2. Në Shtojcën 5, “Specifikimet teknike”, të dokumentave të tenderit është parashikuar si vijon:

**Specifikimet teknike për
“Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”**

- **Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**
 - **Format A5, me përmasat e jashtme 234±5mm x 152±5mm, letër vetkopjuese.**
 - **Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.**
 - **Me birosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.**
 - **Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.**

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

Pesha : 58 + - 4% g/m²

Trashësia: 80+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lëmueshmeria > 15 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Patejdukshmëria > 79 %

Ndricimi 102 + - 3 %

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

Pesha: 58 + - 4% g/m²

Trashësia 78+ - 5 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 30 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

Faqja tretë- kopja para CF coated front

Pesha: 60 + - 4% g/m²

Trashësia: 73+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 mN

Lëmueshmeria > 30 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

- Letër A4 "Traktor" në 3 kopje

- **Format A4 me përmasat e jashtme: 234±5mm x 304± 5mm, letër vetkopjuese,**
- **Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.**
- **Me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.**
- **Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.**

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

Pesha: 58 + - 4% g/m²

Trashësia: 80+ - 6 μm

Ashpersia ne perkulje: MD > 11 mN

Ashpersia ne perkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 15 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Patejdukshmëria > 79 %

Ndricimi 102 + - 3 %

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

Pesha: 58 + - 4% g/m²

Trashësia: 78+ - 5 μm

Ashpersia në perkulje: MD > 11 mN

Ashpersia në perkulje: CD > 3 mN

Lëmueshmëria > 30 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

Faqja tretë- kopja para CF coated front

Pesha: 60 + - 4% g/m²

Trashësia: 73+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 12 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 4 mN

Lëmueshmëria > 30 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

III.9.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.9.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.9.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.9.6. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, të modifikuara nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.6 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)). Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

III.9.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik akimues, referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostra për artikujt letër traktor A4 dhe letër traktor A5, ku secila nga fijet e letrës përbëhet nga tre kopje, faqja e parë, e dytë dhe e tretë.

Sa më sipër, referuar pretendimeve e operatorit ekonomik ankimues për testimin e këtyre mostrave, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, në mbështetje të pikës 5 të nenit 115 të LPP, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik "Infosoft

Office” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të këtyre mostrave.

Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër për produktet Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5 me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit dhe informacion mbi kostot dhe tarifat e analizave të këtyre produkteve.

Me anë të shkresës nr. 172 prot., datë 22.02.2024, protokolluar pranë KPP me nr. 141/9 prot., datë 23.02.2024 shoqëria “Eko-Studio Projekt” SHPK bën me dije analizat për të cilat është i akredituar për të kryer, si dhe tarifat për kryerjen e tyre.

Në datën 08.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 255/2024, për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Infosoft Office”, SHPK “Marketing & Distribution” SHPK, “Inpress” SHPK dhe, konkretisht të mostrave të dorëzuar nga këto të fundit për artikujt Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5.

Në datën 13.03.2024, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt një seancë dëgjimore, me përfaqësues të shoqërisë “Adel Co” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, “Inpress” SHPK, “Infosoft Office” SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, u përzgjedhën mostrat që do ti nënshtroheshin testimit.

Me anë të shkresës nr.250 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr.169/14 datë 29.04.2024, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, për shoqëritë “Infosoft Office” SHPK, “Inpress” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, dhe “Adel Co” SHPK. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm rezultatet janë si më poshtë:

Për shoqërinë “Infosoft Office” SHPK: Gramatura për letër A4, Faqja e parë 53.782 g/m2, Faqja e ddytë 62.009 g/m2 dhe Faqja e tretë 59.638 g/m2, Trashësia: Faqja I 68 µm, Faqja II 72 µm, Faqja III 72 µm, ndërsa për letër A5 Faqja e parë 53.694 g/m2, Faqja e dytë 59.770 g/m2 dhe Faqja e tretë 60.800 g/m2, Trashësia: Faqja I 68 µm, Faqja II 72 µm, Faqja III 74 µm,

III.9.8. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha:*

58 + - 4% g/m2; trashësia 80+ - 6 µm, *Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha* 58 + - 4% g/m2; *Trashësia:* 78+ - 5 µm, *Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha:* 60 + - 4% g/m2, *Trashësia,* 73+ - 6 µm, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha:* 58 + - 4% g/m2; *trashësia* 80+ - 6 µm, *Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha* 58 + - 4% g/m2; *Trashësia:* 78+ - 5 µm , *Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha:* 60 + - 4% g/m2, *Trashësia,* 73+ - 6 Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje

mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Adel CO” SHPK qëndron.

III.10 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se, “*ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.10.1 Në dokumentat e tenderit Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, parashikohet si më poshtë vijon:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<i>Artikulli</i>	<i>Përshkrimi i mallit</i>	<i>Sasia</i>	<i>çmimi per njesi</i>	<i>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</i>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<i>Çmimi total (Mallrat)</i>				_____
<i>Çmimi Neto pa TVSH</i>					
<i>TVSH (%)</i>					
<i>Çmimi total me TVSH:</i>					
<i>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</i>					
<i>Nënshkrimi</i>					
<i>Vula</i>					
<i>Datë</i> _____					

III.10.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 2080/26 prot., datë 02.02.2024 protokolluar me tonën me nr. 141/6 prot., datë 02.02.2024 rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Infosoft Office” SHPK, është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO i është drejtuar operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me kërkesë për sqarim për oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.10.3. Në përgjigje të kërkesës së KVO, me shkresën datë 29.12.2023 me objekt: “Sqarim për ofertë anomalisht të ulët”, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka argumentuar si më poshtë:

“ [...] Nepermjet sistemit elektronik ne daten 27.12.2023 ka mberritur prane zyrave tona nje kerkese nga ana juaj, permes te ciles na kerkohej argumentim i ofertes anomalisht te ulet, te paragitur nga Infosoft Office sh.p.k. ne tenderin me objekt "Loti i II-të: "Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Leter A4 "Traktor" (3 kopje)" te zhvilluar ne daten 20.11.2023.

Per te sqaruar:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara

Shpjegojme:

Per tju sqaruar lidhur me anen ekonomike te kesaj oferte po ju paraqesim nje analize te detajuar te kostos, me perlllogaritje per cdo artikull, dhe me te gjitha elementet perberese te cmimeve, mbeshetur ne oferta te marra nga furnitoret tane. Sa me siper vertetohet aftesia e shogerise tone per te blere artikujt me cmimet e deklaruar dhe

realizimin me sukses te kontrates.

Per te sqaruar:

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka

ofertuesi per kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

Shpjegojme:

Infosoft Office eshte kompani lider ne tregun shqiptar per tregtimin e artikujve te kancelerise, letres dhe tonerave, me nje pervoje mbi 25 vjecare, me mundesi financiare te konsoliduara, me nje xhiro vjetore per, per vitin 2020: 894,144,598 leke, per vitin 2021:979,602,980 leke, dhe per vitin 2022: 1,073,644.035 leke. Kompania jone ka statuse shume te privileguara perfaqesimi per marka te ndryshme produktesh. Kjo na jep mundesine te perfitojme cmime shume favorizuese.

Sa me lart, produktet objekt prokurimi, qe shoqeria jone ka ofertuar, jane konform te gjitha specifikimeve teknike te percaktuara ne DST.

Me alternativa te ngjashme, te ofertuara ne kete procedure prokurimi, Infosoft Office sh.p.k ka kuotuar, fituar dhe realizuar me sukses nje sere kontratash me ente publike, ku gjithashtu ka rezultuar me oferte anomalisht te ulet. Shoqeria jone ka realizuar me sukses nje sere kontratash ku kemi rezultuar me oferte anomalisht te ulet, si psh Bashkia Durrës, Universiteti i Tiranës, Githashtu shoqeria jone ka nenshkruar me institucionin tuaj ne vitin 2021 nje kontrate me objekt te njejte prokurimi, e cila ka rezultuar e realizuar me sukses nga ana jone.

Qindra kontratat e realizuara me sukses ne shume vite pune tregojne qarte mundesine e Infosoft Office sh.p.k. per te realizuar keto furnizime ne kohe dhe cilesi, si edhe aftesine per te ofruar zgjidhje teknike per furnizimin e mallrave ne sasi te medha, ne nje kohe te shkurter.

Per te sqaruar:

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi:

Shpjegojme:

Konfirmojme se artikujt e ofertuar nga kompania jone plotesojne te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit dhe te gjitha standartet nderkombetare te cilesise. Permes dokumentave te paraqitur ne tender kemi marre persiper plotesimin e te gjitha specifikimeve te artikujve, gje qe e rikonfirmojme edhe nje here. Gjithashtu kemi paraqitur ne tender cdo dokument qe ju keni pare te arsyeshme te kerkoni, per tu siguruar per cilesine e produkteve, objekt prokurimi.

Per te sqaruar:

c) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Shpjegojme:

Per t'ju konfirmuar qe kompania jone ploteson te gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim nje vertetim te pageses se rregullt te detyrimeve te sigurimeve shogerore dhe shendetesore.

Kompania jone eshte e certifikuar sipas standarteve nderkombetare me ISO 9001 per Sistemin e Menaxhimit e Cilesise, BS PASS 99:2012 per Sistemin e Menaxhimit te Integruar, ISO 45001 per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune dhe ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ne vendet ku ushtrojme aktivitetin apo ofrojme sherbimet (bashkangjitur).

Ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik, kerkojme nga ju qe te gjitha dokumentat shoqerues te permendura me lart, te administrohen si informacion konfidencial, te perdoren vetem per qellimin e kerkuar dhe te mos ju behen te ditura paleve te treta.

Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin, mbetemi ne dispozicionin tuaj per cdo sqarim te metejshem dhe jemi te gatshem te paragesim cdo dokumentacion shtese te nevojshem.

Për të sqaruar

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore

Shpjegojmë:

Shoqëria jonë nuk është në kushtet ku përfiton ndihmë shtetërore.

Bashkëngjitur kësaj shkrese, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur në autoritetin kontraktor analizën e kostos për zërat e sipërpërmendur; ofertë nga Algrafika SHPK, ofertë nga Euroform Shtypshkrime shpk, vërtetim realizim kontrate me nr. 1079/1 prot., datë 12.05.2022+ bashkëlidhur kontratën, vërtetim realizimi nr. 245 prot., datë 22.02.2021, vërtetim realizimi kontrate nr. 1628 prot., datë 24.02.2021, vërtetim realizimi

kontrate nr. 7313 prot., datë 17.02.2020, vërtetim realizimi kontrate 989/1 prot., datë 05.03.2021, certifikatë konformiteti BS PAS 99:2012, EN-ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit me nr. T09503454, datë 04.12.2023, vërtetim nr. T09601798, datë 19.12.2023 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatim paguesin E-SIG 02/a .

III.10.4. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.10.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.10.6 Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 36, 750,200 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e

ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i

përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.10.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të fashikullit administrativ rezulton, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertës në datën **27.12.2023**, i ka kërkuar operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Me anë të shkresës datë **29.12.2023** me shkresën me lëndë “Sqarim për ofertë anomalisht të ulët”, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur informacion në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, nga e cila rezulton, se ky i fundit krahas sqarimit narrativ ka paraqitur dhe një analizë të përlllogaritjes së çmimeve të shitjes dhe ofertat/kuotimet që kanë marrë nga prodhuesit direkt të këtyre materialeve, konkretisht oferta lëshuar nga shoqëria “Algrafika” SHPK, e cila mban datën **13.11.2023**, ofertë lëshuar nga shoqëria Euro Form Shtypshkrime Shpk që mban datë 14.11.2023, vërtetim realizim kontrate me nr. 1079/1 prot., datë 12.05.2022+ bashkëlidhur kontratën, vërtetim realizimi nr. 245 prot., datë 22.02.2021, vërtetim realizimi kontrate nr. 1628 prot., datë 24.02.2021, vërtetim realizimi kontrate nr. 7313 prot., datë 17.02.2020, vërtetim realizimi kontrate 989/1 prot., datë 05.03.2021, certifikatë konformiteti BS PAS 99:2012, EN-ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit me nr. T09503454, datë 04.12.2023, vërtetim nr. T09601798, datë 19.12.2023 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatim paguesin E-SIG 02/a.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton, se nga ana e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK është paraqitur tabela me emërtimin “Analizë kostoje”, e cila përmban analizën e kostos për letër letër traktor A5 dhe letër traktor A4 sipas të cilës reflektohen, sasia, cmimi i ofertuar pa tvsh, vlera e ofertuar pa tvsh, cmimi blerje lëndë e parë pa tvsh, vlera pa tvsh, sasia në copë e kutive për ambalazhim, cmimi/copë i kutisë pa tvsh, vlera e kutive pa tvsh, kosto e punës/fije treshe pa tvsh, vlera e punës pa tvsh. Gjithashtu janë paraqitur shpenzime të përgjithshme, kosto transporti për lëvrim, kosto amortizimi makineri dhe thika, kosto të tjera (kosto qeraje, energji elektrike, noterizime etj), fitimi mesatar. Gjithashtu Komisioni konstaton se, nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, rezulton, se operatori ekonomik Infosoft Office SHPK ka paraqitur ofertë lëshuar nga shoqëria “Algrafika” SHPK, e cila mban datën **13.11.2023**, ofertë lëshuar nga shoqëria Euro Form Shtypshkrime Shpk që mban datë 14.11.2023. Në këto kushte Komisioni gjykon, se referuar preventivit të zërave të ofruar, sipas parashikimeve në dokumentet e tenderit për zërat e sipërcituar është paraqitur analizë kosto e detajuar duke justifikuar listën e çmimeve të ofruara në ofertën ekonomike.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, nuk ka arritur të argumentojë elementet e ofertës së tij për të cilët

autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime, siç parashikohet në nenin 93 të LPP-së si më sipër cituar, duke krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron

III.11 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se: “.....OE nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin letër A 5 traktor (3 kopje), letër A4 traktor (3 kopje)....të kërkuar në pikën 2.3.5 “kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të shtojcës 7, kriteret e vecanta të kualifikimit të DST, në origjinal ose kopje të përkthyer dhe njehsuar me origjinalin.....OE Infosoft Office shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5 “kapaciteti ekonomik dhe financiar”...pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar së bashku me skedën teknike të kërkuar sipas specifikimeve” në origjinal ose kopje të përkthyer dhe njehsuar me origjinalin.”...b) Gjithashtu bazuar në formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur nga OE Infosoft Office shpk. Nuk vërtetohet lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lëndë e parë me prodhuesin e letrës traktor...

C) skeda teknike për të dyja llojet e letrës traktor të paraqitur nga OE Infosoft SHPK nuk është firmosur ose/ dhe vulosur nga kompania prodhuese e lëndës së parë letër kimike dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet kurrsesi e certifikuar nga prodhuesi i lëndës së parë....Skedat teknike për të dyja llojet e letrës të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5 “Specifikimet teknike të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.11.1 Në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.5. Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të

pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

III.11.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokument autorizimi datë 11.08.2022 lëshuar nga shoqëria Mitsubishi Hitec Paper për shoqërinë Algrafika SHPK me përmbajtje si më poshtë: *“Në Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, me adresë Niedernholz 23, 33699 Bielefeld Gjermani, që jemi prodhues zyrtar të letrës pa karbon, me fabrika në Gjermani, deklarojmë se furnizojmë Algrafika shpk, autostrada Tr-DR Km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me produkte të prodhuara në fabrikat tona. Algrafika shpk është distributori ynë i autorizuar në shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH për tregun shqiptar, në sektorin privat dhe publik.”*, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Originalin nr.rep 5954, datë 03.11.2022, me firmë dhe vulë noteriale si dhe dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5955, datë 03.11.2022;
- Skede teknike faqja e tretë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Originalin nr.rep 5543, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5547, datë 15.11.2023;
- Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB shoqëruar me Vërtetim Njësie me Originalin nr.rep 5544, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi me nr. Rep 5546, datë 15.11.2023.
- Skede teknike faqja e parë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB e shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep 5542, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi me nr. Rep 5548, datë 15.11.2023
- Skedë teknike “Infosoft Office” SHPK, specifikimet teknike letër e vazhduar (traktor) A4, letër e vazhduar (traktor) A5,
- Autorizim i lëshuar nga distributori I autorizuar nga prodhuesi Algrafika shpk, datë 15.11.2023 më përmbajtje si vijon:.....*kompania algrafika shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, kashar, tiranë, në cilësinë e distributorit të autorizuar të prodhuesit të letrës kimike “Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH”, autorizon shoqërinë infosoft office shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri që të prodhojë dhe të ofertojë produktet për procedurën Loti II-të: “Blerje letër A5 traktor (3 kpje), letër A4 “Traktor” (3 kopje) me numër REF-84246-10-18-2023 që do të zhvillohet me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor Sha posta Shqiptare. Garantojmë suport të plotë ndaj Infosoft office shpk me gjithë furnizimet e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi “Mitsubishi Hitec Paper europe Gmb” sipas specifikimeve teknike të kërkuara,...*”

III.11.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.11.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.11.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në interpretim të kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka ndarë dy momente në përmbushje të tij, konkretisht “Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specififikimet teknike të

kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, "Traktor" (3 kopje); Letër A4 "Traktor" (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomik prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, "Traktor" (3 kopje); Letër A4 "Traktor" (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse."

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues "Infosoft Office" SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Dokument autorizimi datë 11.08.2022 lëshuar nga shoqëria Mitsubishi Hitec Paper për shoqërinë Algrafika SHPK me përmbajtje si më poshtë: *"Në Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, me adresë Niedernholz 23, 33699 Bielefeld Gjermani, që jemi prodhues zyrtar të letrës pa karbon, me fabrika në Gjermani, deklarojmë se furnizojmë Algrafika shpk, autostrada Tr-DR Km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me produkte të prodhuara në fabrikat tona. Algrafika shpk është distributori ynë i autorizuar në shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH për tregun shqiptar, në sektorin privat dhe publik."*, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5954, datë 03.11.2022, me firmë dhe vulë noteriale si dhe dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5955, datë 03.11.2022;Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF, shoqëruar me Vërtetim Njësie me Origjinalin nr.rep 5543, datë 15.11.2023 dhe vërtetim përkthimi nr. Rep. 5547, datë 15.11.2023;Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF;Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB, Skedë teknike "Infosoft Office" SHPK, specifikimet teknike letër e vazhduar (traktor) A4, letër e vazhduar (traktor) A5,

Autorizim i lëshuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi Algrafika shpk, datë 15.11.2023 më përmbajtje si vijon: *".....kompania Algrafika shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, kashar, tiranë, në cilësinë e distributorit të autorizuar të prodhuesit të letrës kimike "Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH", autorizon shoqërinë infosoft office shpk me adresë autostrada tiranë durrës, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri që të prodhojë dhe të ofertojë produktet për procedurën Loti II-të: "Blerje letër A5 traktor (3 kpje), letër A4 "Traktor" (3 kopje) me numër REF-84246-10-18-2023 që do të zhvillohet me datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor Sha posta Shqiptare. Garantojmë suport të plotë ndaj Infosoft office shpk me gjithë furnizimet e nevojshëm të lëndës së parë të prodhuar nga prodhuesi "Mitsubishi Hitec Paper europe Gmb" sipas specifikimeve teknike të kërkuara,..."*

Pra, sa më sipër, operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK, me anë të dokumentacionit të mësipërm vërteton se do të furnizohet me produktin e lëndë e parë *"letër kimike"* nga shoqëria Algrafika, e cila është distributori për Shqipërinë, nga shoqëria prodhuese Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH.

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku *me skedën teknike të produktit të ofertuar*, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Ndërsa operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin *skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor*, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në përmbushje të kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, të modifikuar, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke qenë së është prodhues i produktit final letrës traktor, ka paraqitur autorizimin e distributorit për lëndën e parë për prodhimin e letrës, nga Algrafika SHPK, si dhe skedën teknike për letrën e përdorur, të lëshuar nga prodhuesi i lëndës së parë Mitsubishi Hitec Paper europe GmbH.

III.11.6 Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK , mbi verifikimin e skedave teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, gjykojmë, se për sa kohë është realizuar testimi i mostrave pretendimi mbi verifikimin e skedave teknike nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.12 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me arsyetimin se “...*OE Infosoft Office” SHPK në kundërshtim me pikën 2.3.6 “kapaciteti teknik” të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit të DST nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST...kemi bindjen se mostrat e paraqitura nga OE Infosoft Office SHPK nuk janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” – “kapaciteti teknike” pika 2.3.6 të DST për sa i përket: i. Përmasës/formatit. Ii. Peshës së secilës faqe (faqeve 1,2,3) të mostrave të dorëzuara, iii. Trashësisë së secilës faqe (faqeve 1,2,3) të mostrave të dorëzuara...Për këtë arsye kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrave të dorëzuara nga OE Infosoft Office*

shpk, nga Laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë për verifikimin e përputhshmërisë të mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në DST...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.12.1 Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, KPP ashtu sic ka argumentuar në pikën III.9.8. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m2; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha 58 + - 4% g/m2; Trashësia: 78+ - 5 µm, Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m2, Trashësia, 73+ - 6 µm, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m2; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha 58 + - 4% g/m2; Trashësia: 78+ - 5 µm , Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m2, Trashësia, 73+ - 6.*

Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratorit “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezultojnë se mostrat e dorëzuara nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Inpress” SHPK qëndron.

III.13 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK se: “...kemi bindjen se OE Marketing & Distribution SHPK në kundërshtim me pikën 2.3.6 “kapaciteti teknik” të shtojcës 7, kriteret e veccanta të kualifikimit në DST nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST...Në lidhje me këtë riter kualifikues ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE Marketing & Distribution SHPK nuk janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në Shtojcën 7 “Kriteret e veccanata të kualifikimit – kapaciteti teknik pika 2.3.6 të DST përse i përket peshës/formatit, peshës së secilës faqe të mostrave të dorëzuara ...Për këtë arsye kërkojmë

nga kSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren hapa të nevojshme verifikuese të testimit të mostrave të dorëzuara nga OE Marketing & Distribution nga laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë për verifikimin e përputhshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të DST.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.13.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing e Distribution”, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur në **pikën III. 6.8** të këtij vendimi duke argumentuar se, KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa-CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha 58 + - 4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm, Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6 µm*, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha 58 + - 4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm , Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6*. Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, qëndron.

III.14. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, gjykojmë, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë ky operator ekonomik nuk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik

ankimues “Inpress” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.15 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK se “....OE Adel CO shpk do duhet të skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe Financiar” të shtojës 7, Kriteret e vecanta të kualifikimit të DST, pasi nuk ka xhiron vjetore të realizuar për tre vite viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të arrijnë vlerën e xhiros minimale jo më pak se 199 % të vlerës limit për lotin përkatës/shumatores së loteve për të cilat ofertuesi konkurren në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.15.1. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, shtojca 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, është modifikuar si më poshtë:

Pika 2.2.1 ISHTE:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 199% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.2.1 BËHET:

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për **xhiron vjetore** të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të arrijnë vlerën e xhiros minimale në jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.*

III.15.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësisimit të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Adel CO” SHPK ka dorëzuar:

- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel Co” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Ndërtimi” SHPK; konkretisht për pikën 2.2.1, Kapacitetin ekonomik dhe financiar, lidhur me xhiron vjetore.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Ndërtimi” SHPK të firmosur dhe vulosur si subjekt mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për pikën 2.2.1, Kapacitetin ekonomik dhe financiar, lidhur me xhiron vjetore.
- Marrëveshje Angazhimi datë 10.11.2023, ku pala mbështetëse “Ndërtimi” SHPK deklaroi se do të mbështetë shoqërinë “Adel Co” SHPK për pikën 2.2.1 të kapacitetit

ekonomik dhe financiar të kriteretve të veccanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit.

- Vërtetimin nr. T09331457, datë 03.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë.
- Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë.

III.15.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.15.4. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë

maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.15.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.15.6 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK me arsyetimin se nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.2.1 kapaciteti ekonomik dhe financiar për xhiron vjetore ku përcaktohet se **“2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të arrijnë vlerën e xhiros minimale në jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron”**, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel Co” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Ndërtimi” SHPK; konkretisht për pikën 2.2.1, Kapacitetin ekonomik dhe financiar, lidhur me xhiron vjetore, si dhe Vërtetim nr. T09331457, datë 03.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve

Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2020, xhiroja vjetore e vitit 2021, xhiroja vjetore e vitit 2023 të subjektit “Adel Co” SHPK

Nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit, për operatorin ekonomik “Ndërtimi” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Ndërtimi” SHPK të firmosur dhe vulosur si subjekt mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për pikën 2.2.1, Kapacitetin ekonomik dhe financiar, lidhur me xhiron vjetore, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion që do të mbështesë subjektin “Adel Co” SHPK për pikën 2.2.1 të kriterëve të veccanta të kualifikimit, konkretisht xhiron vjetore. Gjithashtu ka dorëzuar marrëveshje Angazhimi datë 10.11.2023, ku pala mbështetëse “Ndërtimi” SHPK deklaron se do të mbështesë shoqërinë “Adel Co” SHPK për pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veccanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë.

Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operatorë ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, ka deklaruar si një nga subjektet në kapacitetet e të cilit do të mbështetet, operatorin ekonomik “Ndërtimi” SHPK, ku përveç Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, ka paraqitur edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK. Gjithashtu ka paraqitur dhe një Marrëveshje Angazhimi të datës 10.11.2023 midis palës mbështetëse “Ndërtimi” SHPK dhe palës së mbështetur “Adel Co” SHPK në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete ekonomike dhe financiare, konkretisht në përmbushje të pikës 2.2.1 shoqërinë “Adel Co” SHPK dhe kjo e fundit pranon këtë mbështetje. Në këtë kontekst, KPP, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK, Komisioni gjykon se, në pikën 1 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPPsë; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.15.7. Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr. T09331457, datë 03.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2020, xhiroja vjetore e vitit 2021, xhiroja vjetore e vitit 2023 të

subjektit “Adel Co” SHPK, si dhe Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2020, xhiroja vjetore e vitit 2021, xhiroja vjetore e vitit 2023 të subjektit “Ndërtimi” SHPK.

Nga verifikimi i vërtetimit të lëshuar për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “Ndërtimi” SHPK rezulton se xhiroja e realizuar në një prej viteve të deklaruar përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.2.1 konkretisht vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.**

Pra, që të quhet i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK duhet të plotësojë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, dhe referuar Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë në emër të “Ndërtimi” SHPK mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel CO” SHPK rezulton se për vitin 2020 vlera e xhiros është 10,856,785, për vitin 2021 vlera e xhiros rezulton të jetë 158,569,390, për vitin 2022 rezulton 234,448,222.

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi vlera e xhiros për të paktën nga vitet e periudhës së kërkuara pasi arrin vlerën e **jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron** që i korrespondon vlera prej 130,273,360 lekë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” nuk qëndron.

III.16 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK me argumentimin se: “...Ofertuesi nuk ka aritur të përmbushë kriterin për kualifikim të përcaktuar në: në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të kualifikimit të shtojcës 7 të DT-së e konkretisht kriterin për kualifikim me përmbajtjen si vijon: “2.2.1 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për **xhiron vjetore** të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, **ku në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të arrijnë vlerën e xhiros minimale në jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.16.1 Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK, KPP ashtu sic ka argumentuar në pikën III.14.7. të këtij vendimi, në rastin konkret shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr. T09331457, datë 03.11.2023, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2020, xhiroja vjetore e vitit 2021, xhiroja vjetore e vitit 2023 të subjektit “Adel Co” SHPK, si dhe Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë në të cilin pasqyrohet

xhiroja e vitit 2020, xhiroja vjetore e vitit 2021, xhiroja vjetore e vitit 2023 të subjektit “Ndërtimi” SHPK.

Nga verifikimi i vërtetimit të lëshuar për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “Ndërtimi” SHPK rezulton se xhiroja e realizuar në një prej viteve të deklaruar përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.2.1 konkretisht vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë ***jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.***

Pra, që të quhet i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK duhet të plotësojë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, dhe referuar Vërtetim nr. T08839088, datë 10.08.2023 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë në emër të “Ndërtimi” SHPK mbi kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Adel CO” SHPK rezulton se për vitin 2020 vlera e xhiros është 10,856,785, për vitin 2021 vlera e xhiros rezulton të jetë 158,569,390, për vitin 2022 rezulton 234,448,222.

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi vlera e xhiros për të paktën nga vitet e periudhës së kërkuara pasi arrin vlerën e ***jo më pak se 199% të vlerës limit për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron*** që i korrespondon vlera prej 130,273,360 lekë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” nuk qëndron.

III.17 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK se “...Ofertuesi nuk ka arritur të paraqesë si pjesë të ofertës së tij në SPE, skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, e cila të jetë e certifikuar nga prodhuesi dhe ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5 “Traktor” 3 kopje, letër A4, Traktor 3 kopje. Nuk janë paraqitur skedat teknike për të dy llojet e letrës traktor në të cilat të jenë të pasqyruara dhe me anë të së cilave të plotësohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga AK ...ofertuesi adel co nuk ka arritur të dorëzojë një dokument i cili të vërtetojë lidhjen prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lëndë e parë me prodhuesin e letrës traktor...” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.17.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit pika 2.3.5 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar si më poshtë:

2.3.5. Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet

teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, "Traktor" (3 kopje); Letër A4 "Traktor" (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, "Traktor" (3 kopje); Letër A4 "Traktor" (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

III.17.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Adel Co" SHPK, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokumentin letër autorizimi, datë 11.08.2022, lëshuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH me përmbajtje « ...ne, Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, adresa Niedernholz 23, 33699 Bielefeld, gjermani, që jemi prodhues zyrtarë të letrës pa karbon, me fabrika në gjermani, deklarojmë përmes këtij dokumenti që i furnizojmë shoqërisë Algrafika shpk, autostrada Tr-Dr, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, **produktet e prodhurara në fabrikat tona.** Algrafika SHPK është distributori ynë i autorizuar për shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, në sektorin privat dhe publik ».
- Dokumenti Autorizim i lëshuar nga Distributor i autorizuar nga prodhuesi, datë 13.11.2023, lëshuar nga Algrafika SHPK për Adel Co SHPK me përmbajtje si vijon : «subjekti Algrafika SHPK me NIPT J91601504N me dresë autostrada TR-Dr, km 8, Kashar, Tiranë është distributor i autorizuar i produktit « letër kimike », autorizon subjektin « Adel Co » shpk me NIPT L22117021M dhe adresë RR « Myslym Keta ». Tiranë të shesë produktin letër kimike, sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit.... »
- Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A5, e përkthyer dhe noterizuar;
- Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A5, përkthyer dhe noterizuar;
- Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A5, përkthyer dhe noterizuar;
- Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A4, e përkthyer dhe noterizuar;

- Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A4, përkthyer dhe noterizuar;
- Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A4, përkthyer dhe noterizuar;

III.17.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.17.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.17.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në interpretim të kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka ndarë dy momente në përmbushje të tij, kokretisht “Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.”

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes “Adel Co” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Dokumentin letër autorizimi, datë 11.08.2022, lëshuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH me përmbajtje « ...ne, Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, adresa Niedernholz 23, 33699 Bielefeld, gjermani, që jemi prodhues zyrtarë të letrës pa karbon, me fabrika në gjermani, deklarojmë përmes këtij dokumenti që i furnizojmë shoqërisë Algrafika shpk, autostrada Tr-Dr, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri, **produktet e prodhurara në fabrikat tona**. Algrafika SHPK është distributori ynë i autorizuar për shitjen e letrës pa karbon të prodhuar nga Mitsubishi HiTec Paper Europe GmbH, në sektorin privat dhe publik ».

Dokumenti Autorizim i lëshuar nga Distributor i autorizuar nga prodhuesi, datë 13.11.2023, lëshuar nga Algrafika SHPK për Adel Co SHPK me përmbajtje si vijon: «subjekti Algrafika SHPK me NIPT J91601504N me dresë autostrada TR-Dr, km 8, Kashar, Tiranë është distributor i autorizuar i produktit « letër kimike », autorizon subjektin « Adel Co » shpk me NIPT L22117021M dhe adresë RR « Myslym Keta ». Tiranë të shesë produktin letër kimike, sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit.... »

Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A5, e përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A5, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A5, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A4, e përkthyer dhe noterizuar;

Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A4, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A4, përkthyer dhe noterizuar

Pra, sa më sipër, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, me anë të dokumentacionit të mësipërm vërteton se do të furnizohet me produktin e lëndë e parë “letër kimike” nga

shoqëria Algrafika, e cila është distributori për Shqipërinë, nga shoqëria prodhuese Mitsubishi Hotec Paper Europe GmbH.

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku *me skedën teknike të produktit të ofertuar*, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specififikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specififikimet teknike përkatëse.

Ndërsa operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin *skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor*, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specififikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specififikimet teknike përkatëse.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK, sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, në përmbushje të kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, duke qenë së është prodhues i produktit final letrës traktor, ka paraqitur autorizimin e distributorit për lëndën e parë për prodhimin e letrës, nga Algrafika SHPK, si dhe skedën teknike për letrën e përdorur, të lëshuar nga prodhuesi i lëndës së parë Mitsubishi Hitec Paper europe GmbH.

Përsa I përket pretendimit se, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk ka paraqitur skedë teknike për dy llojet e letrës tractor nga verifikimi I dokumentacionit të dorëzuar rezulton se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A5, e përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A5, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A5, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e parë CF – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CF A4, e përkthyer dhe noterizuar;

Skede teknike faqja e dytë CFB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CFB A4, përkthyer dhe noterizuar; Skede teknike faqja e dytë CB – Technical Data Sheet, giroform, Ultra CB A4, përkthyer dhe noterizuar, duke e përmbushur këtë pikë të kriterëve të veccanat të kualifikimit.

III.17.6. Lidhur me këto pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, mbi verifikimin e specifikimeve të skedave teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK gjykojmë, se për sa kohë është realizuar testimi i mostrave pretendimi mbi verifikimin e skedave teknike nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK nuk qëndron.

III.18 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” me arsyetimin se: “...nisur nga mostrat e dorëzuara në përmbushje të kriterit të mësipërm për kualifikim, përfaqësuesit e shoqërisë sonë prezent në dorëzimin e mostrave në autoritetin kontraktor, kanë konstatuar se letra e përdorur si lëndë e parë për prodhimin e mostrave të kërkuara, pra për letrën A5 traktor (3 kopje) dhe letër A4 traktor 3 kopje nuk plotësojnë cilësinë e kërkuar në shtojcën 5 të DT gjë e cila është konstatuar me sy të lirë...Kërkojmë që mostrat e dorëzuara nga ofertuesi “Adel Co” SHPK të dërgohen për tu analizuar në një laborator të akredituar për produktet e letrës...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.18.1. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, është parashikuar:

2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje)** dhe **një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**).**

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 8, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.18.2. Në Shtojcën 5, “Specifikimet teknike”, të dokumentave të tenderit është parashikuar si vijon:

***Specifikimet teknike për
“Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”***

- **Letër A5 "Traktor" në 3 kopje**

- **Format A5, me përmasat e jashtme 234±5mm x 152±5mm, letër vetkopjuese.**
- **Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.**
- **Me biosrje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.**
- **Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.**

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

Pesha : 58 + - 4% g/m²

Trashësia: 80+ - 6 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lëmueshmeria > 15 Bekk S

Lagështira relative 50+ - 8 %

Patejdukshmëria > 79 %

Ndricimi 102 + - 3 %

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

Pesha: 58 + - 4% g/m²

Trashësia 78+ - 5 μm

Ashpërsia në përkulje: MD > 11 mN

Ashpërsia në përkulje: CD > 3 mN

Lemueshmeria > 30 Bekk S

Lageshtira relative 50+ - 8 %

Ndricimi 94+ - 3 %

Faqja tretë- kopja para CF coated front

Pesha: 60 + - 4% g/m²

<i>Trashësia:</i>	$73+ - 6 \mu m$
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	$MD > 12 mN$
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	$CD > 4 mN$
<i>Lëmueshmeria</i>	> 30 Bekk S
<i>Lagështira relative</i>	$50+ - 8 \%$
<i>Ndricimi</i>	$94+ - 3 \%$

- Letër A4 "Traktor" në 3 kopje

- *Format A4 me përmasat e jashtme: $234 \pm 5 mm \times 304 \pm 5 mm$, letër vetkopjuese,*
- *Letër traktor me 3 (tre) kopje, të treja të bardha.*
- *Me biosje në të dy anët dhe në fund të formatit për lehtësi shkëputje të jetë e perforuar.*
- *Paketimi në kuti me 1400 (një mijë e katërqind) fije treshe.*

Faqja e parë - kopje prapa- CB – Coated Back

<i>Pesha:</i>	$58 + - 4\% g/m^2$
<i>Trashesia:</i>	$80+ - 6 \mu m$
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	$MD > 11 mN$
<i>Ashpersia ne perkulje:</i>	$CD > 3 mN$
<i>Lemueshmeria</i>	> 15 Bekk S
<i>Lageshtira relative</i>	$50+ - 8 \%$
<i>Patejdukshmëria</i>	$> 79 \%$
<i>Ndricimi</i>	$102 + - 3 \%$

Faqja e dytë – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back

<i>Pesha:</i>	$58 + - 4\% g/m^2$
<i>Trashësia:</i>	$78+ - 5 \mu m$

<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 11 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 3 mN</i>
<i>Lëmueshmëria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

Faqja tretë- kopja para CF coated front

<i>Pesha:</i>	<i>60 + - 4% g/m2</i>
<i>Trashësia:</i>	<i>73+ - 6 µm</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>MD > 12 mN</i>
<i>Ashpërsia në përkulje:</i>	<i>CD > 4 mN</i>
<i>Lëmueshmëria</i>	<i>> 30 Bekk S</i>
<i>Lagështira relative</i>	<i>50+ - 8 %</i>
<i>Ndricimi</i>	<i>94+ - 3 %</i>

III.18.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.18.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.18.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.18.6. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, të modifikuara nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.6 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)). Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

III.18.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik akimues, referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga

operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostra për artikujt letër traktor A4 dhe letër traktor A5, ku secila nga fijet e letrës përbëhet nga tre kopje, faqja e parë, e dytë dhe e tretë.

Sa më sipër, referuar pretendimeve e operatorit ekonomik ankimues për testimin e këtyre mostrave, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, në mbështetje të pikës 5 të nenit 115 të LPP, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të këtyre mostrave.

Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër për produktet Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5 me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit dhe informacion mbi kostot dhe tarifat e analizave të këtyre produkteve.

Me anë të shkresës nr. 172 prot., datë 22.02.2024, protokolluar pranë KPP me nr. 141/9 prot., datë 23.02.2024 shoqëria “Eko-Studio Projekt” SHPK bën me dije analizat për të cilat është i akredituar për të kryer, si dhe tarifat për kryerjen e tyre.

Në datën 08.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 254/2024, nr. 255/2024, nr. 256/2024 për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Infosoft Office”, SHPK “Marketing & Distribution” SHPK, “Inpress” SHPK dhe, konkretisht të mostrave të dorëzuar nga këto të fundit për artikujt Letër traktor A4 dhe Letër traktor A5.

Në datën 13.03.2024, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt një seancë dëgjimore, me përfaqësues të shoqërisë “Adel Co” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, “Inpress” SHPK, “Infosoft Office” SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, u përzgjedhën mostrat që do të nënshtroheshin testimit.

Me anë të shkresës nr.250 prot., datë 25.04.2024, protokolluar me tonën me nr.169/14 datë 29.04.2024, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, për shoqëritë “Infosoft Office” SHPK, “Inpress” SHPK, “Marketing & Distributin” SHPK, dhe “Adel Co” SHPK. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm rezultatet janë si më poshtë:

Për shoqërinë “Adel Co” SHPK: Gramatura për letër A4, Faqja e parë 56.244 g/m², Faqja e ddytë 59.326 g/m² dhe Faqja e tretë 59.183 g/m², Trashësia: Faqja I 74 µm, Faqja II 74 µm, Faqja III 74 µm, ndërsa për letër A5 Faqja e parë 56.832 g/m², Faqja e dytë 59.780 g/m² dhe Faqja e tretë 60.033 g/m², Trashësia: Faqja I 74 µm, Faqja II 74 µm, Faqja III 73 µm,

III.18.8. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Peshë: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Peshë 58 + -*

4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm, Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6 µm, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m²; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha 58 + - 4% g/m²; Trashësia: 78+ - 5 µm , Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m², Trashësia, 73+ - 6.

Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratorit “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK nuk qëndron.

III.19. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se: *“Operatori ekonomik Inpress SHPK nuk ka arritur të vërtetojë se ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit për të cilin ai ka ofertuar, e konkretisht për procedurën objekt të këtij ankimi e që sipas llogaritjeve duhet të jetë në vlerën jo më pak se 24,876,320 (njëzet e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.19.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur në **pikën III. 1.4** të këtij vendimi duke argumentuar se, Komisioni Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi i rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, pika. **2.3.1** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit të lotit përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të*

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore, ku vërteton se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore dhe subjekte private. si dhe duke hequr nga përlllogaritja faturat të cilat nuk ishin të ngjashme me objektin e prokurimit si (si adeziv, tonera, kancelari etj.), nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, konstaton se këto të fundit përmbushin vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor të realizuar gjatë 3 viteve të fundit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk qëndron.

III.20 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se: *“Ofertuesi nuk ka arritur të paraqesë si pjesë të ofertës së tij në SPE, skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, e cila të jetë e certifikuar nga prodhues dhe ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin letër A5 traktor (3 kopje), letër A4 traktor (3 kopje). Nuk janë paraqitur skedat teknike për të dyja llojet e letrës traktor në të cilat të jenë të pasqyruara dhe me anë të së cilës të plotësohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga AK-ja në shtojcën 5 të DST...Ofertuesi Inpress SHPK nuk ka arritur të dorëzojë me dokumentacionin e kërkuar i cili të vërtetojë lidhjen e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lëndë e parë me prodhuesin e letrës traktor...”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.20.1 Në dokumentat e tenderit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, është parashikuar:

2.3.5. Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të

pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, "Traktor" (3 kopje); Letër A4 "Traktor" (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

III.20.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokument autorizimi/ Letër angazhimi, datë 13.11.2023, lëshuar nga "Office Paper" SHPK, me përmbajtje "...dhe në cilësinë e distributorit të autorizuar, për territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëria prodhuese e letrës vetkopjuese (rulon – CF, CFB, CB) – "Goodëill Group LTD (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.)" – (bashkëlidhur autorizimi i prodhuesit)...
...marr përsipër dhe angazhohem të furnizoj rregullisht kundrejt kushteve të dakordsuara paraprakisht shoqërinë "Inpress" SHPK, me seli në adresën "ish Blloku Magazinave të Tregtisë, Rruga "Siri Kodra", Tiranë...., me të gjithë sasinë e lëndës së parë "letër kimike (rulon – CF, CFB, CB)", që do të mund ti nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për prodhimin e produkteve 1. "Letër A5 "Traktor" në 3 kopje; 2. "Letër A4 "Traktor" në 3 kopje", sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike (skedën teknike) bashkëlidhur kësaj deklaratë/letër angazhimi.", bashkëlidhur skede teknike nga Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.).
- Dokumentin "Deklaratë zyrtare", datë 01.11.2023 lëshuar nga Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.) nëpërmjet kësaj shkrese konfirmojmë se, Office Paper SHPK...është klienti ynë ekskluziv, i drejtpërdrejtë si dhe distributori ynë i besuar – për lëndën e parë "Letër kimike (mbështjelljet – CF, CFB, CB) e nevojshme për prodhimin e produktit "Letër vetkopjuese (CB, CFB, CF)",- Format A5 dhe Format A4-në Shqipëri (informacioni i letrës TDS bashkëngjitur), shoqëruar me Skedë teknike Letër Kopjuese pa Karbon Format A4, A5, CB – E veshur mbrapa (kopja e parë); CFB – E veshur para dhe pas (kopja e dytë), CF – e veshur para (kopja e tretë). (në gjuhën anglisht dhe shqip),

III.20.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.20.4. Neni 40 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 38 rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.20.5. Neni 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.20.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen

ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.20.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në interpretim të kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka ndarë dy momente në përmbushje të tij, kokretisht “Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.”

Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Dokument autorizimi/ Letër angazhimi, datë 13.11.2023, lëshuar nga “Office Paper” SHPK, me përmbajtje “...dhe në cilësinë e distributorit të autorizuar, për territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëria prodhuese e letrës vetkopjuese (rulon – CF, CFB, CB) – “Goodëill Group LTD (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.)” – (bashkëlidhur autorizimi i prodhuesit).....marr përsipër dhe angazhohem të furnizoj rregullisht kundrejt kushteve të dakordsuara paraprakisht shoqërinë “Inpress” SHPK, me seli në adresën “ish Blloku Magazinave të Tregtisë, Rruga “Siri Kodra”, Tiranë...., me të gjithë sasinë e lëndës së parë “letër kimike (rulon – CF, CFB, CB)”, që do të mund ti nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për prodhimin e produkteve 1. “Letër A5 “Traktor” në 3 kopje; 2. “Letër A4 “Traktor” në 3 kopje”, sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike (skedën teknike) bashkëlidhur kësaj deklaratë/letër angazhimi.”, bashkëlidhur skede teknike nga Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.), Dokumentin “Deklaratë zyrtare”, datë 01.11.2023 lëshuar nga Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.) nëpërmjet kësaj shkrese konfirmojmë se, Office Paper SHPK...është klienti ynë ekskluziv, i drejtpërdrejtë si dhe distributori ynë i besuar – për lëndën e parë “”Letër kimike (mbështjelljet – CF, CFB, CB) e nevojshme për prodhimin e produktit “Letër vetëkopjuese (CB, CFB, CF)”, - Format A5 dhe Format A4-në Shqipëri (informacioni i letrës TDS bashkëngjitur), shoqëruar me

Skedë teknike Letër Kopjuese pa Karbon Format A4, A5, CB – E veshur mbrapa (kopja e parë); CFB – E veshur para dhe pas (kopja e dytë), CF – e veshur para (kopja e tretë). (në gjuhën anglisht dhe shqip),

Pra, sa më sipër, operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me anë të dokumentacionit të mësipërm vërteton se do të furnizohet me produktin e lëndë e parë “letër kimike (rulon – CF, CFB, CB)” nga shoqëria Office Paper, e cila është distributori për Shqipërinë, nga shoqëria prodhuese Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.).

Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Ndërsa operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje). Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, në përmbushje të kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, të modifikuar, operatori ekonomik “Inpress” SHPK, duke qenë së është prodhues i produktit final letrës traktor, ka paraqitur autorizimin e distributorit për lëndën e parë për prodhimin e letrës, nga Office Paper SHPK, si dhe skedën teknike për letrën e përdorur, të lëshuar nga prodhuesi i lëndës së parë Goodëill Group Limited (QINGDAO FOCUS PAPER CO.,LTD.)

III.20.8. Lidhur me këto pretendime të ngritura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, mbi verifikimin e skedave teknike, gjykojmë, se për sa kohë është reaktuar testimi i mostrave pretendimi mbi verifikimin e skedave teknike nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK nuk qëndron

III.20 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me arsyetimin se: “...kërkojmë që mostrat e dorëzuara nga ofertuesi “Inpress” SHPK të dërgohen për tu analizuar në një laborator të akredituar për produktet e letrës”, Komisioni i Prokurimit Publik është

shprehur në pikën III.4.8 me arsyetimin se KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 29.04.2024 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstatohet se, mostrat e paraqitura për testim nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, pasi për Letër traktor A4 në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m2; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back – Pesha 58 + - 4% g/m2; Trashësia: 78+ - 5 µm, Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m2, Trashësia, 73+ - 6 µm*, ndërsa për Letër A5 Traktor në specifikimet teknike është kërkuar *Faqja e pare - kopje prapa- CB – Coated Back - Pesha: 58 + - 4% g/m2; trashësia 80+ - 6 µm, Faqja e dyte – kopje para dhe prapa- CFB coated front and back - Pesha 58 + - 4% g/m2; Trashësia: 78+ - 5 µm , Faqja trete- kopja para CF coated front - Pesha: 60 + - 4% g/m2, Trashësia, 73+ - 6.*

Sa më sipër, duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë*”, me Nr. REF-84246-

10-18-2023 me objekt: "Loti II "Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)", me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A..

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Infosoft Office" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë "Infosoft Office" SHPK, "Inpress" SHPK dhe "Marketing & Distribution" SHPK dhe, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë "Adel CO" SHPK, "Inpress" SHPK dhe "Infosoft Office" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri